



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 279 Akti

Nr. 221 Vendimi

Tiranë, më 10.12.2019

V E N D I M

Trupi gjykues nr.1, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Xhensila Pine	Kryesuese
Etleda Çiftja	Anëtare
Valbona Sanxhaktari	Relatore

asistuar nga sekretare gjyqësore, znj. Fiorela Mandro, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Theo Jacobs, në datën 4.12.2019, ora 15:00, zhvilloi në Pallatin e Koncerteve, salla B, kati 0, në Tiranë, seancën dëgjimore mbi çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: **Znj. Anita Jella**, prokurore/drejtuese në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës, e pranishme në seancën dëgjimore.

OBJEKTI: **Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.**

BAZA LIGJORE: **Neni 179/b i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë** dhe nenet “A”, “Ç”, “D”, “DH”, “E” dhe “Ë” të Aneksit të Kushtetutës;

Ligji nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

Ligji nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;

Ligji nr. 49/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar.

TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,

pasi dëgjoi arsyetimin ligjor dhe rekomandimin e relatores së çështjes, znj. Valbona Sanxhaktari, dëgjoi shpjegimet e subjektit të rivlerësimit dhe analizoi provat shkresore të paraqitura në vijim të rezultateve të hetimit. si dhe shqyrtoi dhe analizoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Znj. Anita Jella është subjekt i rivlerësimit për shkak të pozicionit të saj si prokurore/drejtuese në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës.

2. Bazuar në nenin 14, pika 2, të ligjit nr. 84/2016, si dhe në rregulloren “Për procedurat e zhvillimit të shortit”, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, në vijim, ka hedhur shortin në datën 15.3.2019, nga i cili rezultoi se subjekti i rivlerësimit i është nënshtruar procesit të rivlerësimit nga trupi gjykues nr. 1, i përbërë nga:

Xhensila Pine	Komisionere
Etleda Çiftja	Komisionere
Valbona Sanxhaktari	Komisionere

3. Znj. Anita Jella është kandidatë për Prokurorinë e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar, pranë strukturës SPAK dhe i është nënshtruar procesit të rivlerësimit me përparësi.

4. Me vendimin nr. 1 të trupit gjykues, datë 15.3.2019, është vendosur kryesuese znj. Xhensila Pine dhe është deklaruar lidhur me konfliktin e interesit nga të gjithë anëtarët e trupit gjykues.

5. Subjekti i rivlerësimit është njoftuar për përbërjen e trupit gjykues që do të kryente procesin e rivlerësimit dhe ka deklaruar se nuk ka konflikt interesi me pjesëtarët e trupit gjykues.

6. Nga relatori janë administruar raportet e vlerësimit të hartuara nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar dhe Këshilli i Lartë i Prokurorisë. Gjatë procesit të rivlerësimit Komisioni ka komunikuar me subjektin e rivlerësimit nëpërmjet adresës elektronike.

7. Me vendimin nr. 2, datë 18.9.2019, i cili i është komunikuar dhe subjektit të rivlerësimit me anë të adresës elektronike – trupi gjykues vendosi: (i) të përfundojë hetimin kryesisht për subjektin e rivlerësimit, znj. Anita Jella, bazuar në të tria kriteret e vlerësimit: vlerësimin e pasurisë, kontrollin e figurës dhe vlerësimin e aftësive profesionale; (ii) të njoftojë subjektin e rivlerësimit mbi rezultatet e hetimit, ta ftojë për t’u njohur me provat e administruara nga Komisioni, në përputhje me nenin 47 të ligjit nr. 84/2016, nenet 45 - 47 dhe 35 - 40 të Kodit të Procedurave Administrative; (iii) të njoftojë subjektin e rivlerësimit mbi të drejtat që gëzon nga ligji për të kërkuar marrjen e provave të tjera ose thirrjen e dëshmitarit, si edhe afatin brenda të cilit mund t’i ushtrojë këto të drejta dhe të paraqesë parashtrimet e saj.

8. Subjekti i rivlerësimit u njoh me dosjen dhe mori një kopje të saj, si dhe paraqiti shpjegime lidhur me rezultatet e hetimit të Komisionit.

9. Në përputhje me nenin 55, të ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues, me vendimin nr.3, datë 1.10.2019, ftoi subjektin e rivlerësimit, znj. Anita Jella, në seancë dëgjimore, në datën 4.10.2019, ora 10:00, në Pallatin e Kongreseve, kati 0 Tiranë.

10. Në datën 3.10.2019 në Komision dhe pranë Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit u administrua një denoncim anonim për subjektin e rivlerësimit.

11. Në datën 4.10.2019, para seancës dëgjimore, nga Operacioni Ndërkombëtar i Monitorimit u kërkua shtyrja e seancës dëgjimore për të lejuar organet e “Vettingut” të verifikojnë *indiciet* e dhëna së fundmi nga mediat.

12. Trupi gjykues, më tej, vlerësoi kërkesën e paraqitur nga Operacioni Ndërkombëtar i Monitorimit, diskutoi dhe vlerësoi rrethanat e reja të përmendura në kërkesën e ONM-së, nga ku vëren se ka disa elementë të rinj lidhur me hetimin administrativ të zhvilluar deri më tani për subjektin Anita Jella. Në vijim trupi gjykues njoftoi subjektin në seancën dëgjimore të datës 4.10.2019, ora 10:00, në Pallatin e Kongreseve, për shtyrjen e seancës dëgjimore.

13. Trupi gjykues mori në shqyrtim denoncimin e ri të ardhur *online* në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit në datën 3.10.2019, me nr. *** prot., dhe kërkesën e ONM-së, e në vijim vendosi me vendimin nr. 4, datë 4.10.2019: rihapjen e hetimit administrativ, në mënyrë që Komisioni të hetojë me objektivitet të gjitha elementet e reja që janë vënë në dijeni së fundmi të lidhura me procesin e rivlerësimit për subjektin Anita Jella, si dhe njoftoi subjektin e rivlerësimit për vendimin e trupit gjykues.

14. Në datën 6.11.2019 Operacioni Ndërkombëtar i Monitorimit dërgon në Komision një gjetje, sipas pikës 10, të nenit 49, të ligjit nr. 84/2016, për subjektin e rivlerësimit.

15. Më tej, në datën 14.11.2019 Operacioni Ndërkombëtar i Monitorimit dërgon në Komision një “opinion” për subjektin e rivlerësimit.

16. Në lidhje me këto denoncime nga publiku, gjetjen e dërguar në datën 6.11.2019, si dhe “opinionin” e datës 14.11.2019, Komisioni administroi dokumentacion nga institucionet publike dhe private.

17. Në datën 14.11.2019 trupi gjykues vendosi: (i) të përfundojë hetimin administrativ shtesë për subjektin e rivlerësimit, znj. Anita Jella; (ii) të njoftojë subjektin e rivlerësimit mbi rezultatet e hetimit shtesë, ta ftojë për t’u njohur me provat e reja të administruara nga Komisioni, në përputhje me nenin 47, të ligjit nr. 84/2016, nenet 45 - 47 dhe 35 - 40 të Kodit të Procedurave Administrative; (iii) të njoftojë subjektin e rivlerësimit mbi të drejtat që gëzon nga ligji për të kërkuar marrjen e provave të tjera ose thirrjen e dëshmitarit, si dhe afatin brenda të cilit mund t’i ushtrojë këto të drejta dhe të paraqesë parashtrimet e saj.

18. Subjekti i rivlerësimit u njoh me dosjen dhe mori një kopje të saj, si dhe paraqiti shpjegime lidhur me rezultatet shtesë të hetimit të Komisionit.

19. Në përputhje me nenin 55, të ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues ftoi subjektin e rivlerësimit, znj. Anita Jella, në seancë dëgjimore, në datën 4.12.2019, ora 15:00, në Pallatin e Kongreseve, Tiranë.

II. SEANCA DËGJIMORE

20. Seanca dëgjimore u zhvillua në përputhje me kërkesat e nenit 55, të ligjit nr. 84/2016, në datën 4.12.2019, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Theo Jacobs.

21. Në këtë seancë subjekti i rivlerësimit u paraqiti personalisht. Subjekti i rivlerësimit, në seancën dëgjimore, paraqiti shpjegime lidhur me rezultatet e hetimit dhe në përfundim të saj kërkoi konfirmimin në detyrë.

22. Trupi gjykues përfundoi seancën dëgjimore dhe për rrjedhojë, edhe procesin e rivlerësimit për znj. Anita Jella në seancën e datës 10.12.2019, në të cilën subjekti ishte i pranishëm.

III. PROCESI I RIVLERËSIMIT I KRYER NGA KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

23. Procesi i rivlerësimit, i cili kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, është një proces kushtetues që mbështetet në nenin 179/b dhe në Aneksin e Kushtetutës, si dhe në ligjin nr. 84/2016. Anëtarët e Komisionit hetojnë dhe vlerësojnë të gjitha faktet dhe rrethanat e nevojshme për procedurën e rivlerësimit dhe kanë të drejtë të çmojnë, sipas bindjes së tyre të brendshme, çdo *indicie* në tërësi lidhur me rrethanat e çështjes.

24. Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni kreu hetim dhe vlerësim të të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë:

- a) raportin e dorëzuar në Komision nga ILDKPKI-ja dhe provat e dorëzuara nga subjekti në këtë institucioni në “Deklaratën e pasurisë për rivlerësimin kalimtar, ‘Vetting’”;
- b) raportin e dorëzuar në Komision nga DSIK-ja, së bashku me dokumentacionin shoqërues;

- c) informacion të përditësuar nga institucionet ligjzbatuese për subjektin e rivlerësimit, persona të lidhur me të dhe persona të tjerë të lidhur;
- ç) raportin e dorëzuar në Komision nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë, së bashku me materialin shoqërues;
- d) dokumente shkresore nga organet publike dhe private, në përputhje me nenet 49 dhe 50, të ligjit nr. 84/2016;
- dh) deklaratimet nga subjekti i rivlerësimit nëpërmjet komunikimit elektronik;
- e) shpjegimet me shkrim të subjektit të rivlerësimit të paraqitura në përfundim të hetimit kryesisht; dhe
- ë) denoncimet nga publiku.

A. VLERËSIMI I PASURISË

25. Znj. Anita Jella ka dorëzuar deklaratën e pasurisë për procesin e rivlerësimit në ILDKPKI, së bashku me dokumentacionin provues. Kjo deklaratë, në bazë të nenit 33¹, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, iu nënshtrua hetimit administrativ nga ILDKPKI-ja.

25. Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (ILDKPKI), ka dërguar aktin e përfundimit të kontrollit të plotë të pasurisë të subjektit Anita Jella, ku në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera lidhur me këtë subjekt të rivlerësimit, ka konstatuar se:

- *deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin;*
- *ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;*
- *nuk ka kryer fshehje të pasurisë;*
- *nuk ka kryer deklaram të rremë;*
- *subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*

26. Megjithëse sipas kreut IV, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ILDKPKI-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit dhe për të marrë vendim në lidhje me vlerësimin pasuror, referuar vendimit të Gjykatës Kushtetuese nr. 2/2017 dhe kreut VII të ligjit nr. 84/2016, Komisioni, në kryerjen e funksionit të tij kushtetues, realizon një proces të mirëfilltë kontrolli dhe rivlerësimi, që nuk bazohet dhe as është i detyruar nga përfundimet e paraqitura nga organet e tjera ndihmëse.²

27. Deklarata e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, znj. Anita Jella, iu nënshtrua një hetimi administrativ të thelluar, i cili kishte të bënte me verifikimin e vërtetësisë dhe të saktësisë së deklaramëve të bëra nga subjekti i rivlerësimit në lidhje me gjendjen pasurore, burimet e krijimit, të ardhurat, shpenzimet, nëse ka konflikt interesi, fshehje të pasurisë apo deklaram të rremë, si dhe përcaktimin e gjendjes së fakteve dhe rrethanave që kanë lidhje me çështjen.

28. Subjekti i rivlerësimit, znj. Anita Jella, në deklaratën e saj të pasurisë për procesin e rivlerësimit, por edhe pas verifikimit administrativ të kryer nga ILDKPKI-ja, si dhe nga Komisioni, rezulton se ka në pronësi pasuritë si më poshtë vijon:

29. Apartament banimi, i ndodhur në lagjen nr. ***, Rr. “***”, Durrës, i porositur me kontratë sipërmarrjeje, datë 26.8.2011, si dhe me deklaratë noteriale nr. ***, datë 8.10.2016, për ndryshimin e apartamentit me atë të vëllait të bashkëshortit.

¹*Procedura e vlerësimit të pasurisë 1. ILDKPKI-ja, bazuar në deklaramet e pasurive, zhvillon një procedurë të plotë kontrolli në përputhje me ligjin, “Për deklaramin dhe kontrollin e pasurive, detyrimeve financiare të personave të zgjedhur dhe nëpunësve të caktuar publikë”, ligjin “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike” si dhe “Kodin e Procedurave Administrative”.*

² *Vendimi nr. 2/2017 i Gjykatës Kushtetuese, “41. Për rrjedhojë, gjykata vlerëson se pretendimi se organet ekzistuese zëvendësojnë organet e reja të rivlerësimit, është i pabazuar. Sipas nenit 179/b, pika 5, të Kushtetutës, rivlerësimi kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, kurse sipas nenit 4/2 të ligjit: “Komisioni dhe Kolegji i Apelit janë institucionet që vendosin për vlerësimin përfundimtar të subjekteve të rivlerësimit”. Pavarësisht formulimit të kësaj dispozite ajo nuk mund të lexohet në mënyrë të shkëputur, por në harmoni me dispozitat e tjera ligjore që përcaktojnë në mënyrë të detajuar kompetencat e organeve të përfshira në proces, si dhe kompetencat që kryhen vetë Komisioni i Pavarur i Kualifikimit gjatë këtij procesi.”*

Burimi i krijimit: Kredi në vlerën 5.650.000 (pesë milionë e gjashtëqind e pesëdhjetë mijë) lekë, në BKT, marrë nga bashkëshorti i subjektit, z. E. Sh., në vitin 2011, si dhe kursime në shumën 2.500.000 (dy milionë e pesëqind mijë) lekë (deklaruar në deklaratën “Vetting”).

30. Për këtë pasuri nga hetimi ka rezultuar:

30.1 Mospërputhje midis vlerës prej 2.500.000 (dy milionë e pesëqind mijë) lekësh, për pagesën e këstit të parë, të deklaruara në deklaratën “Vetting” nga subjekti dhe vlerës prej 2.200.000 (dy milionë e dyqind mijë) lekësh, deklaruar nga subjekti në deklaratën periodike vjetore të vitit 2010, si gjendje e kursimeve *cash* në fund të vitit, të cilat kanë shërbyer si burim për pagesën e këstit të parë për blerjen e apartamentit.

30.2 Nga analiza financiare duket se subjekti e justifikon me burime të ligjshme pagesën e këstit të parë prej 15.000 (pesëmbëdhjetë mijë) euro, por nuk provohet me dokumentacion kryerja e pagesës së këstit të parë në vlerën 15.000 (pesëmbëdhjetë mijë) euro, nga subjekti i rivlerësimit të shoqëria “***” sh.p.k. (transfertë bankare, mandatarkëtimi nga shoqëria).

30.3 Pagesa e këstit të dytë në vlerën 40.000 (dyzet mijë) euro është kryer nga të ardhurat nga kredia e përfituar në BKT në vitin 2011, për blerjen e këtij apartamenti.

30.4 Pagesa e këstit të tretë në vlerën 12.900 (dymbëdhjetë mijë e nëntëqind) euro rezulton ende e papaguar dhe sipas kontratës duhet të paguhet me lidhjen e kontratës së shitblerjes. Por, vihet re se ka kaluar një kohë e gjatë që subjekti jeton në këtë apartament dhe nuk ka asnjë përpjekje për regjistrim të kësaj prone në regjistrat përkatës, prandaj duket i dyshimtë mospagimi i këstit të tretë nisur edhe nga vlera e konsiderueshme e tij.

30.5 Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar detyrimin që ka ndaj firmës ndërtuese “***” sh.p.k., në vlerën 12.900 (dymbëdhjetë mijë e nëntëqind) euro.

30.6 Gjatë hetimit administrativ të kryer, Komisioni ka konstatuar se nuk është deklaruar përdorimi i banesës së porositur nga vëllai i bashkëshortit, z. A. Sh., gjatë viteve 2011 – 2016 dhe as kthimi i apartamentit firmës së ndërtimit për arsye të shkëmbimit të ndodhur mes apartamenteve, i cili është dokumentuar në vitin 2016.

30.7 Gjatë hetimit administrativ të kryer, Komisioni nuk ka administruar asnjë dokumentacion financiar apo ligjor provues, që të vërtetojë kthimin e vlerës prej 4.070.000 (katër milionë e shtatëdhjetë mijë) lekësh nga shoqëria “***” sh.p.k., të z. A. Sh., paguar si likuidim kësti për blerje apartamenti.

30.8 Gjatë hetimit administrativ të kryer, Komisioni nuk ka administruar asnjë dokumentacion financiar apo ligjor provues, që të vërtetojë se nuk është paguar diferenca e çmimit të shitjes së apartamenteve, për arsye të investimeve të kryera nga subjekti në banesën e parë.

31. Në përfundim të hetimit administrativ, lidhur me këtë pasuri, Komisioni i kërkoi subjektit të shpjegojë bindshëm se të gjitha veprimet e kryera lidhur me përfitimin e këtij apartamenti janë deklaruar saktësisht dhe janë në përputhje me ligjin dhe me burime financiare të ligjshme, si dhe me dokumente ligjore provuese për shlyerjen e detyrimit ndaj z. A. Sh., (kthimin e lekëve të paguara për apartamentin).

32. Subjekti i rivlerësimit, lidhur me problematikat e konstatuara nga Komisioni, ka shpjeguar se në fund të vitit 2010 ka deklaruar gjendjen *cash* të të ardhurave të cilat, më tej, janë paguar në vitin 2011 si kësti i parë për blerjen e apartamentit, si dhe janë deklaruar në deklaratën periodike vjetore veprimet e kryera dhe pakësimi i gjendjes *cash*. Po ashtu, gjatë vitit 2011 janë bërë shpenzime për rregullime të brendshme të apartamentit në vlerën rreth 450.000 (katërqind e pesëdhjetë mijë) lekë dhe në deklaratën “Vetting” është deklaruar e plotë vlera e përdorur për blerjen e apartamentit nga kursimet *cash* dhe të ardhurat nga paga në vlerën prej 2.500.000 (dy milionë e pesëqind mijë) lekësh.

32.1 Subjekti ka sqaruar se pagesa e kështit të parë të apartamentit është bërë në *cash* jashtë zyrës së noterisë, disa momente para lidhjes së kontratës së sipërmarrjes, ky fakt është formalizuar në kontratën noteriale, e cila është nënshkruar nga të dyja palët dhe nga noterja. Në kohën kur është lidhur kontrata nuk ka qenë e detyrueshme që pagesat të kryheshin nëpërmjet llogarisë së noterit.

32.2 Lidhur me pagesën e kështit të fundit, ajo nuk është bërë akoma, pasi, siç edhe është parashikuar në kontratë duhet të paguhet në momentin e lidhjes së kontratës së shitblerjes së apartamentit, e cila do t'i bënte pronarë të kësaj pasurie. Kjo kontratë ende nuk është lidhur nga banorët e këtij pallati, pasi firma ndërtuese nuk ka arritur ta regjistrojë objektin në zyrat e regjistrimit të pasurisë. Ky parashikim, në kontratën e sipërmarrjes së apartamentit, ka qenë një “garanci” ligjore në mbrojtje të klientit, pikërisht nga abuzime të këtij lloji. I njëjti detyrim i mbetur pa shlyer ndaj shoqërisë është parashikuar edhe në kontratën e shkëmbimit të vitit 2016, gjë që tregon se nuk ishte paguar ende dhe se qëllimi ishte vetëm të garantohej lidhja e kontratës përfundimtare të shitjes, e cila do të bënte të mundur regjistrimin e pasurisë në emër të blerësve. Prej subjektit janë bërë përpjekje të vazhdueshme që apartamenti të regjistrohet në regjistrat përkatës, por një gjë e tillë nuk është e mundur, pasi ligji për regjistrimin e pasurive të paluajtshme ia ka lënë ekskluzivisht firmës ndërtuese këtë të drejtë, njëkohësisht dhe detyrim. Në bazë të ligjit nr. 33/2012, regjistrimi i pasurisë (ndërtesa shumëkatëshe, të realizuar me leje ndërtimi) bëhet pasi shoqëria ndërtuese të marrë aktet e kolaudimit dhe lejet e shfrytëzimit nga bashkia.

32.3 Në situatën juridike të krijuar, subjekti, si palë, jo vetëm nuk është privilegjuar nga shoqëria lidhur me mospagimin e kështit të fundit në favor të saj, por është pala e dëmtuar drejtpërdrejtë nga veprimet e shoqërisë, e cila ende nuk ka bërë të mundur regjistrimin e pasurisë (pallat) në emër të saj, duke bllokuar kalimin e pronësisë në favorin e subjektit dhe të të gjithë banorëve të tjerë të pallatit.

32.4 Lidhur me pagimin e diferencës së çmimit të shitjes së apartamentit për arsye të investimeve të kryera në banesën e parë, subjekti ka sqaruar se i ka deklaruar në deklaratën “Vetting” dhe, po ashtu, janë deklaruar dhe njohur edhe në kontratën e shkëmbimit të vitit 2016.

32.5 Lidhur me kthimin e shumës së parapaguar shtetasit A. Sh., (vëllai i bashkëshortit) nga shoqëria e ndërtimit, shtetasit F. V., marrëdhënia midis tyre ka qenë e pavarur nga subjekti dhe e vetmja lidhje ka qenë fakti se kur paratë të ktheheshin, atëherë mund të bëhej edhe ndryshimi i kontratës për shkëmbimin e apartamentit. Vazhdimisht është ndjekur kjo marrëdhënie vetëm për faktin se subjekti ka qenë i interesuar në përpilimin e kontratës së shkëmbimit të apartamentit dhe ka rënë dakord që shkëmbimi të bëhej me likuidimin e plotë të vlerës së paguar nga shtetasi A. Sh., për blerjen e apartamentit, gjë e cila në atë kohë, sipas marrëveshjes midis tyre, do të bëhej shumë shpejt. E vetmja gjë që subjekti ka ditur ishte fakti se shtetasi F.V., ka qenë në vështirësi financiare (sipas deklarimeve të tyre) dhe për këtë arsye është zgjatur likuidimi i vlerës së çmimit ndaj shtetasit A. Sh., nga shoqëria e ndërtimit deri në vitin 2016.

32.6 Lidhur me deklarimin e përdorimit të apartamentit të shtetasit A. Sh., subjekti sqaron se në deklaratat periodike vjetore është dhënë adresa e banimit, e cila është e njëjtë për të dy apartamentet, pasi ndodhen në të njëjtin pallat.

33. Nga një informacion mediatik³ rezulton se ndaj shtetasit F. V., në vitin 2009 ka pasur një procedim penal në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Durrës, për arsye se në lagjen nr. ***, Rr. ****, Durrës, nga shoqëria ndërtuese **** sh.p.k., është shembur një pjesë e rrugës dhe e trotuareve me qëllim ndërtimin e një pallati me 10 kate (sipas të dhënave rezulton se ky është edhe pallati ku banon subjekti).

³ Për më tepër, shihni portalin www.lajme.gen.al të datës 11.8.2009.

34. Komisioni iu drejtua Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës dhe Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, lidhur me çështje të mundshme të shoqërisë ndërtuese “****” sh.p.k., në këto institucione.

34.1 Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës⁴ na bën me dije se në emër të shtetasit F. V., dhe të shoqërisë ndërtuese “****” sh.p.k., është regjistruar procedimi nr. ***, datë 12.8.2009, për veprën penale të parashikuar nga neni 155 i Kodit Penal, për të cilin është marrë vendimi i pushimit në datën 12.2.2010. Nga shqyrtimi i praktikës rezulton se veprimet hetimore në këtë procedim penal janë kryer nga prokurorja D. P.

34.2 Pas kërkesës së Komisionit, Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan⁵ informon se në emër të shtetasit F. V., dhe të shoqërisë ndërtuese “****” sh.p.k., nuk rezulton të jetë regjistruar ndonjë kallëzim apo procedim penal në ngarkim të tyre.

35. Tokë bujqësore, me sip 1.000 m², nga e cila 700 m² arë dhe 300 m² truall, e ndodhur në fshatin ***, Bulqizë. Pjesa takuese: 1/3.

Mënyra e fitimit të pronësisë: fituar me aktin e marrjes së tokës në pronësi si anëtare e familjes bujqësore në vitin 1991.

Kjo pasuri është deklaruar nga subjekti edhe në deklaratën periodike vjetore të vitit 2003.

Komisioni konstatoi se deklaratimet e subjektit përputhen me dokumentacionin e administruar dhe nuk konstatoi problematika lidhur më këtë pasuri.

36. Automjet tip “Ford Fiesta”, viti i prodhimit 2004, blerë në vlerën 150.000 (njëqind e pesëdhjetë mijë) lekë.

Mënyra e fitimit të pronësisë: kontratë shitblerjeje, datë 3.9.2016.

Burimi i krijimit: kursimet familjare nga pagat (deklarata “Vetting”).

Komisioni nuk konstatoi problematika lidhur më këtë pasuri.

37. Likuiditete në llogari rrjedhëse të pagës në vlerën 9.349 (nëntë mijë e treqind e dyzet e nëntë) lekë në “Raiffeisen Bank”.

Komisioni konstatoi se deklarimi i subjektit përputhet me dokumentacionin e administruar.

38. Hetimi administrativ kryesisht, i kryer nga Komisioni, u shtri edhe më tej se ai i deklaruar nga vetë subjekti i rivlerësimit. Për këtë është kërkuar informacion nga Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike, Ujësjellës Kanalizime, Drejtoria e Përgjithshme e Transportit Rrugor, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, Zyrat e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, ALUIZNI, Qendra Kombëtare e Biznesit, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dhe Ministria e Drejtësisë (regjistri noterial shqiptar).

Nga hetimi nuk rezultoi ndonjë pasuri e padeklaruar, e fshehur në pronësi apo në përdorim nga subjekti të rivlerësimit, apo personat e lidhur me të.

➔ PERSONA TË TJERË TË LIDHUR

39. Znj. V. J., (gjyshja e subjektit) dhe z. H. J., (vëllai) janë persona të tjerë të lidhur.

Në deklaratat e interesave privatë të viteve 2003, 2004, 2005, 2007 dhe 2008, subjekti i rivlerësimit ka qenë në trungun familjar me gjyshen e saj, znj. V. J., dhe me të vëllanë, z. H.J.

⁴ Për më tepër, shihni shkresën nr. *** prot., datë 11.7.2019. Gjithashtu, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës informon edhe mbi materialin hetimor nr. ***, datë 25.9.2017, për veprën penale “ndërtim i paligjshëm”, për të cilin është marrë vendimi i mosfillimit në datën 9.10.2017. Sipas shortit elektronik të datës 25.9.2017 materiali kallëzues i ka kaluar për ndjekje prokurorit A. Sh.

Gjithashtu, Prokuroria informon mbi procedimin penal nr. ***, datë 31.12.2018, për veprën penale “mashttrim me pasoja të rënda”, të parashikuar nga neni 143/3 i Kodit Penal. Në lidhje me këtë procedim është dërguar kërkesa për pushim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës në datën 15.3.2019. Sipas shortit manual të datës 24.12.2018 materiali kallëzues i është caktuar për ndjekje prokurores R. H. Gjykata e rrethit ka vendosur kthimin e akteve me vendimin nr. ***, datë 19.6.2019, për të cilin prokurori i çështjes ka ushtruar ankim.

⁵ Për më tepër shihni shkresën nr. *** prot., datë 3.7.2019.

Hetimi i kryer nga Komisioni

- Shkresë nr. *** prot., datë 20.6.2019, drejtuar Agjencisë Shtetërore të Kadastrës.
- Shkresë e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës (ASHK) drejtuar 45 drejtorive vendore të ASHK-së dhe zyrave vendore të ASHK-së me nr. *** prot., datë 26.6.2019, ardhur përgjigjet.
- Shkresë nr. *** prot., datë 20.6.2019, drejtuar OSHEE-së.
- Shkresë nr. *** prot., datë 5.7.2019, kthim përgjigjeje e OSHEE-së.

Nga informacioni i ardhur nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës⁶, së cilës i është kërkuar informacion mbi pasuri të paluajtshme të regjistruara në emër të gjyshes dhe të vëllait të subjektit, ka rezultuar vetëm një pronë në emër të shtetasës V. J., pasuria arë me sip. 700 m² me nr. pasurie nr. ***, vol. ***, f. ***, e regjistruar sipas AMT-së me nr. *** akti, si përfaqësuese e familjes bujqësore.

OSHEE-ja, me shkresën nr. ***, datë 5.7.2019, informon se shtetasit me gjeneralitetet V.J., dhe H. J., nuk rezultojnë të jenë abonentë dhe të kenë kontratë furnizimi me energji elektrike me Operatorin e Shpërndarjes së Energjisë Elektrike.

Nga informacioni i nxjerrë nga faqja zyrtare e Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare rezulton se vëllai i subjektit të rivlerësimit, z. H. J., ka prerë policat e sigurimit TPL për automjetet e mëposhtme:

- “Mercedes-Benz”, modeli C 200, viti i prodhimit 1994, periudha 2012 – 2017.
- “Mercedes-Benz”, modeli 208 D, viti i prodhimit 1986, periudha 2012 – 2013, përdorues (mjeti i përkiste Qendrës Spitalore Shupenzë).
- “Volswagen Golf IV”, blu, viti i prodhimit 1999, periudha 2015 – 2019, pronar.
- “Daimler Chrysler”, C 200 CDI, viti i prodhimit 2005, periudha 2017 – 2019, pronar.

Nga hetimi administrativ për këta dy shtetas duket se nuk ka pasuri që mund t’i përkasin subjektit të rivlerësimit ose personave të lidhur me të.

40. Z. A. Sh., (vëllai i bashkëshortit të subjektit)

40.1 Referuar marrëdhënies së subjektit të rivlerësimit dhe të bashkëshortit të saj me shtetasin A.Sh. (vëllai i bashkëshortit) për apartamentin në Durrës dhe problematikave të hasura, Komisioni vlerësoi të hetojë edhe lidhur me pasuritë e shtetasit A. Sh.

40.2 Nga hetimi administrativ nuk rezultuan të dhëna të dyshimta në emër të shtetasit A. Sh., apo pasuri që mund t’i përkasin subjektit të rivlerësimit ose personave të lidhur me të, përveçse pasurisë apartament në Durrës të sipërtrajtuar.

41. Z. S. Sh., dhe znj. N. Sh., (prindërit e bashkëshortit të subjektit)

Prindërit e bashkëshortit të subjektit janë konsideruar persona të tjerë të lidhur me subjektin, për sa i përket disa kredive të marra së bashku dhe veprimeve të kryera për shlyerjen e kredive. Nga hetimi administrativ i kryer rezultoi se kreditë ishin shlyer rregullisht në përputhje me kontratat përkatëse të kredisë dhe se palët kishin burime të mjaftueshme nga të ardhura të ligjshme për pagimin e kësteve përkatëse të kredisë.

42. Analiza financiare për vitet 2003 – 2016

Nga analiza financiar e kryer për vitet 2003 – 2016, subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshorti i saj, rezultojnë me balancë pozitive dhe se justifikojnë pasuritë e krijuara, detyrimet dhe shpenzimet e kryera me të ardhura të ligjshme.

⁶ Shkresa nr. *** prot, datë 20.6.2019.

43. Në datat 3 dhe 4 tetor 2019 në Komision erdhi një denoncim anonim dhe disa informacione mediatike të shpërndara nga disa portale *online* dhe në vijim edhe një kërkesë nga Operacioni Ndërkombëtar i Monitorimit lidhur me vlerësimin e këtyre informacioneve. Në vijim, trupi gjykues vlerësoi materialet dhe kërkesën e paraqitur nga Operacioni Ndërkombëtar i Monitorimit dhe vendosi të riçelë hetimin për subjektin e rivlerësimit për të hetuar lidhur me dyshimet e ngritura dhe rrethanat konkrete të pretenduara.

44. Sipas informacionit të marrë nga portali *pamfleti.net*, znj. Anita Jella banon në një “apartament suitë” te ***, me vlerë 130.000 (njëqind e tridhjetë mijë) euro, që deklaroi se e ka blerë me kursimet nga paga mujore.

44.1 Lidhur me vlerën e blerjes së apartamentit, Komisioni gjatë hetimit administrativ ka administruar të gjitha kontratat e porosisë/sipërmarrjes së lidhura nga shoqëria ndërtuese “****” sh.p.k., për apartamentet në pallatin ku jeton subjekti. Pas shqyrtimit të tyre është hartuar tabela e mëposhtme:

Nr.	Sipërfaqja m2	Cmimi i blerjes	Cmimi/m2	
1	93	55 800 €	600 €	
2	93	60 450 €	650 €	
3	113	67 800 €	600 €	
4	93	30 000 €	323 €	
5	98	50 000 €	510 €	
6	67	44 000 €	657 €	
7	275	173 250 €	630 €	
8	118	94 400 €	800 €	
9	134	93 800 €	700 €	
10	67	33 500 €	500 €	
11	113	73 450 €	650 €	
12	113	65 000 €	575 €	
13	136,45	86 625 €	635 €	
14	137,55	86 625 €	630 €	
15	118	94 400 €	800 €	
16	93	55 800 €	600 €	
17	93	55 800 €	600 €	
18	93	55 800 €	600 €	
19	67	41 800 €	624 €	
20	113	72 000 €	637 €	
21	113	65 000 €	575 €	
22	93	65 000 €	699 €	
23	97	67 900 €	700 €	
24	68	37 400 €	550 €	
25	118	94 400 €	800 €	
26	140,5	80 000 €	569 €	
27	68	30 000 €	441 €	
28	67,81	41 000 €	605 €	
29	67,81	41 000 €	605 €	
30	97	67 900 €	700 €	E. Sh.
31	113	71 190 €	630 €	A. Sh.

Nga verifikimi i kryer ka rezultuar se çmimi i blerjes së apartamentit nga subjekti i rivlerësimit është një çmim i ngjashëm me banorët e tjerë të pallatit dhe brenda kufijve të çmimeve të tregut.

44.2 Komisioni i kërkoi OSHEE-së historikun e kontratës me shtetasin F.T., për apartamentin e porositur nga shtetasi E. Sh., nga ku rezultoi se kjo kontratë është hapur nga shtetasi F. T., më 28.9.2017.

44.3 Nga historiku i saj nuk u ngritën dyshime mbi përdorimin e apartamentit nga subjekti i rivlerësimit.

44.4 Nisur nga denoncimi mediatik në portalin *pamfleti.net*, se subjekti banon në një “apartament suitë” te ***, me vlerë 130.000 (njëqind e tridhjetë mijë) euro, Komisioni në datën 5.11.2019 i kërkoi subjektit të rivlerësimit që t’i mundësonte vullnetarisht një vizitë në banesën ku jeton aktualisht në Durrës.

44.5 Subjekti i rivlerësimit shprehu gatishmërinë për kryerjen e vizitës kurdo që Komisioni e çmonte të arsyeshëm, duke iu përgjigjur kërkesës menjëherë.

44.6 Në vijim, trupi gjykues vlerësoi gatishmërinë e subjektit, por vendosi që t’i kërkojë subjektit:

- të paraqesë foto të të gjithë ambienteve të brendshme të apartamentit në katin e katërt ku jeton, foto të jashtme të katit dhe hyrjes;

- të provojë me dokumentacion ligjor provues (librezën e energjisë elektrike), apo çdo lloj dokumentacioni tjetër se për këtë apartament ka paguar energjinë elektrike, duke filluar nga viti 2011;

- të paraqesë dokumentacion ligjor provues (librezën e energjisë elektrike), apo çdo lloj dokumentacioni tjetër për apartamentin nr. ***, në katin e dytë, për periudhën 2011 deri në momentin e kthimit të këtij apartamenti shtetasit F. T.

44.7 Subjekti paraqiti një sërë fotosh të apartamentit, si dhe të shkallëve dhe të ambienteve të jashtme të pallatit.

44.8 Subjekti paraqiti dokumentacion provues lidhur me apartamentin nr. ***, katin e dytë të cilit e ka blerë fillimisht dhe më tej e ka shkëmbyer me apartamentin në katin e katërt, nga ku rezulton se është bashkuar më apartamentin nr. ***, kati i dytë i të cilit, gjithashtu, posedohet nga shtetasi F.T., i cili ka qenë edhe pronar i truallit ku është ndërtuar pallati.

44.9 Subjekti ka paraqitur dokumentacion të marrë nga OSHEE-ja, ku vërtetohet se shtetasi E. Sh., është faturuar vetëm për kontratën e furnizimit me energji elektrike për apartamentin në katin e katërt të banimit që posedon aktualisht.

44.10 Referuar shpjegimeve të subjektit, dokumentacionit të administruar gjatë hetimit dhe fotove të vëna në dispozicion, provohet se subjekti i rivlerësimit nuk ka jetuar në apartamentin që kaloi në pronësi të shtetasit F. T., por vetëm në apartamentin e shkëmbyer në katin e katërt. Nga hetimi nuk rezultoi se vlera e apartamentit të blerë nga subjekti i rivlerësimit të ishte e ndryshme nga banorët e tjerë të pallatit. Sipërfaqja e apartamentit përputhej me atë të deklaruar nga subjekti. Në vlerësimin e provave të administruara, trupi gjykues krijoi bindjen se deklaratimet e subjektit të rivlerësimit janë të sakta dhe në përputhje me dokumentacion e administruar.

45. Trupi gjykues i kërkoi subjektit të rivlerësimit informacion lidhur me shtëpinë e ndodhur në lagjen “***”, Peqin, në pronësi të prindërve të bashkëshortit të subjektit. Konkretisht, pasuria truall me sip. 238 m² dhe ndërtesë 135 m², me nr. pasurie ***, z. k. ***, me adresë: lagja “***”, Peqin, e regjistruar në emër të shtetasit S. Sh.

45.1 Në vijim të hetimit administrativ lidhur me këtë pasuri Komisioni ka konstatuar, si më poshtë:

- Në deklaratën periodike vjetore të vitit 2003, të dorëzuar më 24.3.2004, bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit ka deklaruar shtëpi private banimi, me sip. 131 m², lagjja “****”, Peqin, lënë në trashëgimi nga gjyshi, zotërimi 20 %.
- Me kontratën e shitjes nr. ***, datë 18.3.2004, shtetasi S. Sh., blen nga shtetasi M. Sh., pasurinë “truall + ndërtesë 2-katëshe”, me sip. truall 131 m² dhe 96 m² ndërtesë, me nr. pasurie ***, në z. k. ***, me adresë: lagjja “****”, Peqin, në vlerën 500.000 (pesëqind mijë) lekë.
- KRRT-ja Bashkia Peqin, me vendimin nr. ***, datë 27.11.2006, i jep shtetasit S. Sh., lejen e ndërtimit për objektin “shtesë anësore për katin përdhe + katin e parë + ngritje kati i dytë (papafingo)”.
- Në deklaratën periodike vjetore të viteve 2009, 2010 dhe 2011, subjekti deklaroi si adresë banimi të regjistruar në gjendjen civile lagjja “****”, Peqin.

45.2 Nga dokumentacioni i administruar rezultoi se: (a) në datën 30.4.2004 bashkëshorti i subjektit ka marrë kredi në vlerën 15.000 (pesëmbëdhjetë mijë) euro [ose 1.901.100 (një milion e nëntëqind e një mijë e njëqind) lekë], me qëllim rregullimin e shtëpisë së prindërve dhe me dorëzanës prindërit e tij, S., dhe N. Sh; (b) në datën 18.4.2005 bashkëshorti i subjektit ka marrë kredi të re në vlerën 10.000 (dhjetë mijë) euro [ose 1.225.400 (një milion e dyqind e njëzet e pesë mijë e katërqind) lekë], me qëllim arredimin e shtëpisë, me dorëzanës prindërit e tij dhe subjektin e rivlerësimit.

45.3 Subjekti i rivlerësimit deklaroi se këto kredi janë shlyer me kontributin e bashkëshortit të saj dhe familjarëve të tij.

45.4 Këto kredi dhe shlyerja e tyre janë hetuar nga Komisioni dhe janë trajtuar më lart në këtë vendim. Në përfundim të hetimit Komisioni nuk ka konstatuar problematika lidhur me kreditë dhe me mundësitë financiare për shlyerjen e tyre.

45.5 Kjo pasuri ka shërbyer si kolateral: (a) për kredinë e marrë në BKT nga shtetasi E. Sh., në vlerën 5.650.000 (pesë milionë e gjashtëqind e pesëdhjetë) lekë, me kontratën e kredisë bankare me nr. ***, me objekt blerje shtëpie; dhe (b) për kredinë e marrë në BKT nga shtetasi A. Sh., në vlerën 5.000.000 (pesë milionë) lekë, me kontratën e kredisë bankare nr. ***, datë 1.6.2010, me objekt blerje shtëpie.

45.6 Në vijim, subjektit të rivlerësimit iu kërkua të vendosë në dispozicion të Komisionit:

- Fotografi të të gjithë ambienteve të brendshme dhe të jashtme të kësaj pasurie.
- Informacion për kohën dhe mënyrën e krijimit të pasurive me nr. *** dhe nr. ***, procedurën ligjore të ndjekur për bashkimin e këtyre pasurive, si dhe mënyrën e fitimit të truallit me sip. 134 m² nga babai i bashkëshortit të subjektit, pjesë e pasurisë kadastrale me nr. ***.
- Të provojë me dokumentacion provues ligjor burimin e ligjshëm të krijimit të pasurisë.
- Të shpjegojë mospërputhjen midis deklaratimit nga bashkëshorti në deklaratën periodike vjetore të vitit 2003, ku deklarohet pronësia në Peqin e 20 % të pasurisë ndërtesë me sip. 131 m², fituar me trashëgimi ligjore, si dhe mosdeklarimit në deklaratën “Vetting” të pronësisë në Peqin mbi këtë pasuri dhe pas investimeve të kryera ndër vite për rikonstruksionin e saj prej tij dhe kredive të marra për këtë pronë.

45.7 Subjekti ka vënë në dispozicion të Komisionit foto të ambienteve të brendshme dhe të jashtme të shtëpisë.

45.8 Subjekti ka sqaruar se: *“Adresa e deklaruar në deklaratën periodike vjetore në Peqin ka të bëjë me faktin se unë jam celebruar me martesë me shtetasin E. Sh., në vitin 2009, dhe meqë ishte i regjistruar në gjendjen civile të banesës së prindërve të tij (regjistruar në të njëjtin trung familjar deri në vitin 2009 kur kemi lidhur martesë), rrjedhimisht, dhe unë pas martesës kam qenë e regjistruar aty, deri në vitin 2011 kur kemi bërë transferimin e gjendjes civile në Durrës.”*

45.9 Gjatë hetimit subjekti ka deklaruar se ka jetuar në Elbasan dhe pas transferimit në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Durrës ka jetuar me qira në Durrës, përveç disa muajve në periudhën 2010 – 2011, kur ka qenë me leje lindjeje dhe i duhej ndihma e nënës së bashkëshortit.

45.10 Subjekti deklaron se adresa e banimit nga viti 2009 deri në vitin 2011, nuk ka të bëjë me faktin se ka jetuar në atë adresë, por vetëm me faktin se ka qenë e regjistruar në Gjendjen Civile Peqin, për shkak të celebrimit të martesës me shtetasin E. Sh.

45.11 Subjekti i rivlerësimit ka sqaruar se kjo shtëpi është pasuri që i përket familjarëve të bashkëshortit. Gjithashtu, subjekti sqaron se pasuria nr. ***, ka qenë shtëpia ekzistuese e gjyshit të bashkëshortit, z. H. Sh. Me vendimin nr. ***, datë 15.9.1959, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, është vërtetuar fakti se shtetasit M. Sh., dhe H. Sh., (vëllezër me njëri-tjetrin), janë pronarë të një shtëpie banimi me dy kate, me gjashtë dhoma, me dy korridore dhe oborr, ndërtuar në vitin 1905 nga babai i tyre, z. Q. Sh.

45.12 Në vitin 1970 z. H. Sh., ka ndërruar jetë dhe banesa ka mbetur e regjistruar vetëm në emër të z. M. Sh. Kur është bërë regjistrimi i pasurive të vjetra, të para viteve 1990, ka lindur e nevojshme regjistrimi i gjysmës së banesës, përkatësisht në emër të trashëgimitarit të z. H.Sh., djalit të tij, z. S. Sh.

45.13 Meqenëse në regjistrat kadastralë të para viteve 1990, shtëpia kishte mbetur e regjistruar vetëm në emër të z. M. Sh., sepse, sikurse u sqarua edhe më lart, z. H. Sh., kishte ndërruar jetë, lindi e nevojshme që z. M. Sh., t'ia shiste gjysmën e banesës, përkatësisht, z. S. Sh., që të bënte regjistrimin e pronës në emrin e tij.

45.14 Kjo është formalizuar me kontratën e shitjes nr. ***, datë 18.3.2004. Kjo është forma e krijimit të pasurisë nr. ***, shtëpi banimi me sip. 96 m² dhe truall me sip. 131 m².

45.15 Pasuria nr. *** është formuar si pasojë e ndërtimit të një shtese në katin e parë dhe të dytë të pasurisë nr. ***, dhe ngritje papafingo, po në truallin ku ndodhet pasuria nr. ***, dhënë sipas lejes së ndërtimit nr. ***, datë 27.11.2006, nga Bashkia Peqin.

45.16 Për sa i përket burimit të krijimit të investimit të kryer në këtë pasuri, subjekti sqaron se vlera e investimit është 5.085.852 (pesë milionë e tetëdhjetë e pesë mijë e tetëqind e pesëdhjetë e dy) lekë, sipas preventivit të punimeve të kryera të paraqitura në Bashkinë Peqin, e cila është vlerë e përafërt e nxjerrë dhe nga akti i ekspertimit i kryer sipas kërkesës së Komisionit dhe konkretisht vlera 5.067.649 (pesë milionë e gjashtëdhjetë e shtatë mijë e gjashtëqind e dyzet e nëntë) lekë, e cila i korrespondon edhe vlerës së investimit për metër katror në qytetin e Peqinit në vitin 2006. Nga ky akt ekspertimi rezulton se sipërfaqja totale e objektit është 299 m², nga e cila 96 m² janë ekzistuese dhe 203,7 m² janë sipërfaqe anësore dhe shtesë.

45.17 Burimi i këtyre të ardhurave të përdorura në këtë investim janë: dy kreditë familjare përkatësisht për vlerat 15.000 (pesëmbëdhjetë mijë) dhe 10.000 (dhjetë mijë) euro të marra nga bashkëshorti i subjektit në BKT, në vitet 2004 dhe 2005, të cilat referuar kursit të këmbimit të atyre viteve këmbehen me rreth 3.500.000 (tre milionë e pesëqind mijë)lekë; një kredi bankare e marrë nga vëllai i bashkëshortit, z. A. Sh., në “Raiffeisen Bank”, në vlerën 500.000 (pesëqind mijë) lekë; vlera 1.800.000 (një milion e tetëqind mijë) lekë të ardhura të nënës së bashkëshortit, të fituara si pjesë takuese e pallatit të ndërtuar në truallin e babait të saj në Elbasan; dhe pjesa tjetër kursime familjare të krijuara përpara fillimit të ndërtimit dhe gjatë viteve të ndërtimit.

45.18 Lidhur më mospërputhjet, subjekti ka sqaruar se kjo është pasuria ekzistuese e regjistruar me nr. ***, në emër të shtetasit S.Sh., për të cilën është përmendur më lart, i cili sipas origjinës e ka fituar këtë pasuri nëpërmjet trashëgimisë nga i ati dhe me kontratën e blerjes së pjesës ideale nga bashkëpronari tjetër, shtetasi M.Sh., me kontratën e datës 18.3.2004. Si rrjedhim,

rezultun se pronar i vetëm i pasurisë nr. ***, sipas mënyrave të fitimit të pronësisë është vetëm shtetasi S. Sh., pra, i ati i bashkëshortit të subjektit.

45.19 Bashkëshorti i subjektit, në kohën e deklarimit për herë të parë të pasurive, sipas ligjit, nuk ka arritur të kuptojë qëllimin e ligjit, që kishte të bënte me deklarimin dhe të drejtën e pronësisë së fituar ligjërisht mbi një pasuri dhe jo me gjendjen e posedimit të saj. Kështu, ka deklaruar 20 % të pasurisë banesë, në deklaratën e vitit 2003, duke u nisur nga fakti se ishte pjesëtar i një familjeje të përbërë nga 5 anëtarë, e cila jetonte në banesën me nr. *** pasurie dhe kjo pasuri ishte e regjistruar në emër të kryefamiljarit, z. S.Sh. Bashkëshorti i subjektit, pas vitit 2004 nuk ka qenë më subjekt i ligjit për kontrollin dhe deklarimin e pasurive dhe nuk ka pasur detyrim për deklarim. Në deklaratën “Vetting” nuk është deklaruar më si pjesë takuese 20 % i kësaj pasurie, pasi është kuptuar se ky deklarim i bërë në vitin 2003 ka qenë i pasaktë, pasi pasuria ka qenë dhe është e babait të tij, z. S.Sh., për sa kohë është gjallë dhe e ka fituar ligjërisht me trashëgimi dhe më tej me blerje.

45.20 Kontributi i bashkëshortit të subjektit, si pjesëtar i familjes së tij deri në vitin 2009, ka qenë për pagesat mujore së bashku me familjarët e tjerë. Subjekti i rivlerësimit sqaron se nuk ka asnjë kontribut në rikonstruksionin e banesës së prindërve të bashkëshortit.

45.21 Në vlerësim të provave të administruara gjatë hetimit, fotove të vëna në dispozicion, si dhe shpjegimeve të subjektit, trupi gjykues nuk ka dyshime lidhur me këtë pasuri dhe vlerësoi se është pasuri e shtetasit S. Sh., dhe e palidhur me subjektin e rivlerësimit.

46. Gjatë hetimit administrativ Komisioni ka kërkuar informacion nga Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike, Ujësjetës Kanalizime, Drejtoria Rajonale e Shërbimit të Transportit Rrugor Tiranë, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, Zyrat e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, ALUIZNI, Qendra Kombëtare e Biznesit, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dhe Ministria e Drejtësisë.

47. Nga hetimi nuk rezultuan të dhëna apo *indicie* për pasuri të fshehura të subjektit të rivlerësimit apo personave të lidhur.

48. Komisioni përgatiti analizën financiare për periudhën 2003 – 2016, nga e cila rezultoi se subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të kanë pasur të ardhura të mjaftueshme për të justifikuar pasuritë e krijuara, shlyerjen e detyrimeve dhe shpenzimet e kryera, me të ardhura të ligjshme.

Konkluzione për rubrikën e vlerësimit të pasurisë

Nga hetimi i kryer dhe vlerësimi i dokumenteve të administruara në dosje, trupi gjykues arriti në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka bërë deklarim të saktë në përputhje me ligjin. Nga hetimi rezultoi se bilanci financiar është pozitiv dhe subjekti i rivlerësimit nuk ka probleme me pasurinë dhe analizën financiare ndër vite, si dhe ka burime financiare të ligjshme, të mjaftueshme për të justifikuar pasuritë dhe shpenzimet e kryera.

Në vlerësimin e përgjithshëm subjekti i rivlerësimit ka arritur një nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë.

B. KONTROLLI I FIGURËS

49. Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK) ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit. Për këtë qëllim, ka dërguar një raport për subjektin e rivlerësimit në përputhje me nenin 39, të ligjit nr. 84/2016. Ky raport është deklasifikuar plotësisht.

49.1 Sipas këtij raporti subjekti i rivlerësimit ka plotësuar saktë dhe me vërtetësi formularin e deklarimit për kontrollin e figurës, si dhe nuk ka informacione se subjekti ka kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar.

Në përfundim, për subjektin e rivlerësimit konstatohet se është i përshtatshëm për vazhdimin e detyrës.

50. Në Komision kanë mbërritur dy denoncime lidhur me figurën e bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit.

50.1 Nga verifikimi i raportit të përgatitur nga DSIK-ja për shtetasin E.Sh., (gjithashtu, subjekt rivlerësimi), nuk u konstatuan problematika. Raporti konstaton përshtatshmërinë e subjektit për vazhdimin e detyrës.

50.2 Bazuar në nenin 53/2, të ligjit nr. 84/2016, Komisioni i ka konsideruar denoncimet me *indicie* lidhur me kriterin e kontrollit të figurës së bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit dhe ka kryer një hetim të mëtejshëm lidhur me të dhënat nga denoncimet, duke kërkuar informacion në institucionet/organet ligjzbatuese, si dhe nëpërmjet Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit në institucionet e huaja.

a. Denoncimi nr. *** prot., datë 30.4.2019, i ardhur në adresën elektronike të Komisionit nga shtetasi A. Dh. Ky denoncim paraqet informacione në lidhje me bashkëshortin e subjektit, z. E. Sh., si dhe ngre dyshime për lidhje të tij me persona të përfshirë në krimin e organizuar.

Komisioni i ka kërkuar informacion Prokurorisë së Përgjithshme për verifikimin e ndonjë kallëzimi apo procedimi penal të regjistruar në ngarkim të z. E. Sh., si dhe për ndonjë procedim apo kallëzim penal ndaj shtetasit të referuar në denoncim.

➤ Nga përgjigjet e ardhura nuk u konstatuan *indicie* për hetime të mëtejshme.

Lidhur me këtë denoncim është pyetur edhe subjekti i rivlerësimit, nëse ajo apo bashkëshorti i saj, kanë lidhje miqësore dhe kontakte me shtetasin e përmendur.

Përgjigjet e subjektit të rivlerësimit lidhur me këto hetime janë vlerësuar bindëse nga trupi gjykues, i cili në përfundim nuk pati dyshime për kontakte të papërshtatshme të subjektit të rivlerësimit apo bashkëshortit të saj.

b. Denoncimi nr. *** prot., datë 13.5.2019, ardhur nga adresa elektronike identifikuar E., trajton fakte për bashkëshortin e subjektit të rivlerësimit, lidhur me ngjarje të viteve 1998 – 2000 dhe ngre dyshime se bashkëshorti i subjektit mund të ketë përdorur emër tjetër.

Komisioni, në vijim të fakteve të trajtuara në këtë denoncim, i ka kërkuar shpjegime subjektit të rivlerësimit, e cila ka sqaruar se e ka njohur shtetasin E. Sh., në vitin 2003 (në përgjigje të sa është pyetur).⁷

Duke e konsideruar informacionin e denoncuesit me *indicie* që përmbajnë shkaqe të mjaftueshme për fillimin e hetimit kryesisht (neni 53), Komisioni ka vlerësuar të domosdoshëm verifikimin e tij, nisur edhe nga fakti se subjekti i rivlerësimit është kandidat për strukturat SPAK.

Komisioni, për të realizuar këtë verifikim, ka kërkuar nëpërmjet subjektit të rivlerësimit bashkëpunimin e shtetasit E. Sh., me qëllim verifikimin e dyshimeve të ngritura.

Po ashtu, është kërkuar edhe bashkëpunimi i Policisë së Shtetit (Interpolit) për verifikimin e informacionit.

Shtetasi E. Sh., ka pranuar të bashkëpunojë me Komisionin për kryerjen e verifikimeve. Komisioni, në vijim të këtij proces verifikimi, i ka kërkuar shpjegime edhe shtetasit E. Sh.

Në përfundim të verifikimeve të kryera, nuk ka rezultuar që shtetasi E. Sh., të ketë përdorur emër tjetër. Po ashtu, nga hetimi nuk rezultuan të dhëna që të implikonin shtetasin E. Sh., në veprimtari të kundërligjshme, sipas parashikimeve të pikës 1, të nenit 3, të ligjit nr. 10192, datë 3.12.2009, të ndryshuar.

51. Komisioni kërkoi nga institucionet ligjzbatuese përditësim të informacionit lidhur me subjektin e rivlerësimit dhe bashkëshortin e saj.

⁷ Përgjigje pyetësorit nr. 3 (e-mail).

52. Komisioni, në përfundim, nuk konstatoi elemente që të cenonin figurën e subjektit të rivlerësimit, znj. Anita Jella.

Konkluzione për rubrikën e vlerësimit të figurës

Trupi gjykues, pasi shqyrtoi dokumentacionin e dorëzuar prej subjektit të rivlerësimit, deklaratën për kontrollin e figurës, raportin e DSIK-së, informacione nga organet ligjzbatuese, dokumentacionin e administruar gjatë hetimit lidhur me denoncimet, arriti në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka plotësuar formularin e deklaramit për kontrollin e figurës në mënyrë të saktë dhe me vërtetësi.

Nuk u provua që subjekti i rivlerësimit ka pasur kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, apo që të jetë e përfshirë, apo e vënë nën presion nga persona të përfshirë në krimin e organizuar, si rrjedhojë, e gjen të përshtatshme për vazhdimin e detyrës.

Në përfundim, trupi gjykues vlerësoi se subjekti i rivlerësimit, znj. Anita Jella, ka arritur një nivel të besueshëm në kontrollin e figurës.

C. VLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE

53. Vlerësimi i aftësive profesionale nga Komisioni është bazuar në:

- raportin për analizimin e aftësisë profesionale të subjektit të rivlerësimit të kryer nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë;
- materialin e dërguar nga subjekti i rivlerësimit në përgjigje të pyetësorit të datës 16.5.2019, lidhur me veprimtarinë e subjektit si drejtuese pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Durrës;
- denoncimet, sipas nenit 53, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

54. Nga verifikimi i të dhënave nga prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë, si dhe të burimeve arkivore në Prokurorinë e Përgjithshme rezulton se subjekti i rivlerësimit, znj. Anita Jella:

- Nuk ka pasur masa disiplinore.
- Nuk ka të dhëna të dokumentuara të përfshirjes së saj në kontakte me persona të papërshtatshëm.

55. Në vlerësim të tri dokumenteve të përzgjedhura nga subjekti dhe pesë dosjeve të përzgjedhura me short, janë evidentuar këto gjetje lidhur me kriteret e rivlerësimit.

- Është konstatuar se subjekti ka identifikuar drejt normën ligjore të zbatueshme në të gjitha rastet dhe shfaq aftësi në arsyetim ligjor. Në përmbajtjen e tyre (akteve) formohet lidhja midis fakteve dhe konkluzioneve të arritura. Niveli i arsyetimit të akteve të vëzhguara respekton standardin e procesit të rregullt ligjor.
- Nga vëzhgimi i pesë dosjeve gjyqësore të përzgjedhura me short konstatohet se dosjet janë të administruara rregullisht dhe materialet janë të vendosura në rend kronologjik. Në katër nga pesë dosjet e përzgjedhura nuk u konstatuan problematika.
- Nga vlerësimi i dokumenti ligjor – vendim – “për pushimin e çështjes penale”, datë 29.4.2014, lidhur me procedimin penal nr. ***, regjistruar në datën 10.3.2014, pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Durrës, për veprën penale “prodhim dhe shitje e narkotikëve”, parashikuar nga neni 283/1 i Kodit Penal, në ngarkim të shtetasit I. S., Komisioni vëren se:
 - subjekti i rivlerësimit nuk e ka krahasuar kurrë përmbajtjen e deklaratës së të dyshuarit me rezultatet e analizës së urinës – kampion që është marrë nga i dyshuari;
 - subjekti i rivlerësimit asnjëherë nuk urdhëroi marrjen në pyetje të të dyshuarit për ta ballafaquar me rezultatit e analizës së urinës (i cili ishte plotësisht në kundërshtim me deklaratën e mëparshme);

- subjekti i rivlerësimit nuk e hetoi asnjëherë përputhshmërinë midis rezultateve të analizës së urinës dhe substancave që u gjetën në kontrollin e shtëpisë.

➤ ***Në përfundim, Komisioni konstaton se për shkak të sjelljes së subjektit të rivlerësimit, disa mundësi hetimore u humbën plotësisht.***

Subjektit, në lidhje me këtë rezultat, i është kërkuar të japë shpjegime mbi konstatimet e Komisionit, e cila ka shpjeguar në përgjigje të rezultateve të hetimit se: “... materialet nga Drejtoria e Policisë së Qarkut Durrës kanë ardhur në prokurori në datën 10.3.2014, dhe pas kalimit nga zv/drejtuesi i prokurorisë, kanë kaluar tek unë si prokurore e çështjes. Menjëherë nga ana ime, pas studimit të akteve të parahetimore në datën 10.3.2014 është proceduar në zbatim të parashikimeve procedurale penale, lidhur me regjistrimin e çështjes në ngarkim të shtetasit I. S., si i dyshuar për kryerjen e veprës penale të “prodhimit dhe shitjes së narkotikëve”, të parashikuar nga neni 283/1 i Kodit Penal, vlerësimin me vendim për vleftësimin e sekuestros së lëndës së dyshuar si narkotike dhe në vazhdim me përpilimin e kërkesës për vleftësimin e arrestit në flagrancë dhe caktimin e masës së sigurimit personal ndaj shtetasit në fjalë.

Kërkesa për vleftësimin e arrestimit në flagrancë dhe caktimin e masës së sigurimit është depozituar brenda afatit ligjor procedural, në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës në datën 11.3.2014 dhe seanca për shqyrtimin e kësaj kërkesë është zhvilluar në datën 13.3.2014. Në seancën gjyqësore, nga ana ime si përfaqësuese e prokurorisë është mbajtur i njëjti qëndrim si në kërkesat e paraqitur me shkrim, duke qenë se nuk kishin ndryshuar rrethanat e faktit penal dhe provat, duke nënvizuar këtu faktin se nuk ishin administruar ende aktet e ekspertimeve kimik të lëndës të dyshuar si narkotike dhe të mostrës së urinës.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës, me vendimin nr. ***, datë 13.3.2014, ka vlerësuar si të bazuara kërkesat e prokurorisë, duke vendosur vlerësimin si të ligjshëm të arrestimit në flagrancë të të dyshuarit I. S., për veprën penale të parashikuar nga neni 283/1 i Kodit Penal dhe caktimin ndaj tij të masës së sigurimit personal me karakter shtrëngues atë të “arrestit në burg” të parashikuar nga neni 238 i Kodit Penal.

Në vazhdim, nga ana ime, bazuar në nenin 294/2 të Kodi i Procedurës Penale është urdhëruar me shkrim kryerja e disa veprimeve hetimore nga ana e oficerit të policisë gjyqësore, i cili ka kryer edhe veprimet e para hetimore.

Ndërkohë, lidhur me çështjen në fjalë, janë administruar edhe prova të tjera si: - vërtetimi i gjendjes gjyqësore nga ku rezultonte se shtetasi i dyshuar I. S., në bazë të vendimit nr. ***, datë 13.1.2011, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës është deklaruar fajtor për veprën penale të ‘prodhim dhe shitje të lëndëve narkotike’, të parashikuar nga neni 283/1 i Kodit Penal dhe në bazë të kësaj dispozite është dënua përfundimisht me 4 vjet burgim. Gjykata e Apelit Durrës, me vendimin nr. ***, datë 13.7.2011, ka ndryshuar masën e dënimit me 3 vjet e katër muaj burgim; - certifikata personale dhe familjare e personit të dyshuar, nga ku rezultonte se ai është beqar dhe ka në përbërje familjare nënën dhe të vëllanë, G. S.

Ndodhur para të dhënave sa më sipër, bazuar në pikën b, të nenit 328/1, të Kodit të Procedurës Penale, nga ana ime si prokurore në datën 29.4.2014 (datë kur është administruar edhe akti i ekspertimit kimik të lëndës së sekuestruar shtetasit I. S.) është vendosur pushimi i çështjes penale.

Pushimi i çështjes është vendosur pas shqyrtimit të rrethanave të ngjarjes dhe provave të grumbulluara dhe duke ndjekur një vijë logjike arsyetimi. Kështu, fillimisht pasi kam parashtruar ngjarjen kriminale të referuar nga ana e policisë gjyqësore, në vijim jam ndalur në përshkrimin e rezultateve të veprimeve hetimore të kryera, duke dhënë kështu një përmbledhje të qartë të faktit penal referuar provave të grumbulluara dhe duke kaluar në vazhdim me analizimin jo vetëm të elementëve të veprës penale të parashikuar nga neni 283 i Kodit Penal, për të cilën ishte regjistruar edhe procedimi penal, gjithashtu, edhe të veprës

penale të 'mbajtja, prodhimi dhe transportimi i substancave kimike', parashikuar nga neni 285 i Kodit Penal. Në këtë analizë është arsyetuar se referuar rezultateve të ekspertimit kimik dhe ligjit nr. 7975, datë 26.7.1995, 'Për barnat narkotike dhe lëndët psikotrope', në rastin konkret lënda e sekuestruar nuk përfshihet në grupin e substancave narkotike dhe psikotrope apo prekursor dhe, si e tillë, mbajtja e kësaj lënde nuk konsiderohet e kundërligjshme sipas parashikimeve të nenit 283 dhe 285 i Kodit Penal dhe as sipas parashikimeve të dispozitave të tjera të Kodit Penal. Në këtë logjikë, duke qenë se kishim një tablo të qartë të faktit penal objekt hetimi ku është konstatuar mungesa e lëndës narkotike/psikotrope apo prekursorë - të domosdoshëm për ekzistencën e veprave penale të parashikuar nga neni 283 dhe 285 i Kodit Penal dhe mungesë të elementëve të ndonjë veprë tjetër penale të parashikuar në Kodin Penal, është çmuar se në këto kushte, bazuar në pikën b, të nenin 328/1 të Kodit të Procedurës Penale, nuk mund dhe nuk duhej të vazhdohej hetimi i këtij procedimi penal."

56. Subjekti i rivlerësimit mban pozicionin e drejtueses së përkohshme pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Durrës. Komisioni i ka nisur subjektit një pyetësor lidhur me punën e saj organizative në këtë institucion.

Në vlerësim të shpjegimeve të subjektit, në kuadër të ushtrimit të veprimtarisë së saj si drejtuese, Komisioni nuk konstatoi problematika lidhur me vlerësimin profesional të saj.

DENONCIMET E PUBLIKUT

57. Pranë Komisionit janë regjistruar 10 denoncime nga publiku të cilat janë trajtuar dhe vlerësuar nga Komisioni.

a. Denoncimi me nr. *** prot., datë 15.11.2018, i shtetasit S. T.

Ky denoncim i referohet një subjekti, gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës, i cili është kallëzuar për shpërdorim detyre. Denoncuesi pretendon se znj. Anita Jella është bërë pengesë, pasi ka zvarritur vendimin.

Nga verifikimi i fakteve dhe i dokumentacionit rezulton se në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Durrës është regjistruar procedimi penal nr. ***, datë 22.1.2018, regjistruar për veprën penale "falsifikim të dokumenteve", parashikuar nga neni 186 i Kodit Penal. Hetimet janë kryer nga prokurorja e çështjes O. Rr., e cila ka vendosur shpalljen e moskompetencës dhe kalimin e akteve Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Subjekti i rivlerësimit në cilësinë e drejtueses ka nënshkruar shkresën përcjellëse dhe nuk ka marrë pjesë në procedurat hetimore të këtij procedimi penal.

b. Denoncimi me nr. *** prot., datë 12.11.2018, i shtetasës R. R.

Subjekti denoncohet për shpërdorim detyre, pasi ka vendosur mosfillim procedimi penal ndaj dy shtetasve dhe nuk ka marrë parasysh kërkesën për dorëheqje të prokurorit A. Sh.

Nga të dhënat arkivore të Prokurorisë së Përgjithshme rezulton se denoncuesja ka bërë edhe kallëzim penal kundër subjektit të rivlerësimit dhe prokurorit A. Sh., mbi bazën e të cilit është regjistruar në datën 19.11.2018 kallëzimi penal nr. ***, për veprat penale të parashikuara nga nenet 248, 250 dhe 251 të Kodit Penal.

Me vendim të datës 5.12.2018, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë, është vendosur mosfillimi i procedimit penal për materialin kallëzues nr. ***/2018. Kundër këtij vendimi ka ushtruar ankim shtetasja R. R., në vijim të së cilës Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kavajë, me vendimin nr. ***, datë 30.1.2019, ka vendosur: "Rrëzimin e kërkesës së ankueses R. R., kundër vendimit më datë 27.11.2018 të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë, për mosfillimin e procedimit penal për materialin kallëzues nr. ***/2018, si të pabazuar në prova dhe në ligj". Shtetasja R. R., ka ushtruar ankim ndaj këtij vendimi dhe çështja ndodhet në gjykim në Gjykatën e Apelit Durrës.

Subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar se kjo çështje është lënë në fuqi edhe nga Gjykata e Apelit Durrës, duke vënë në dispozicion kopje të vendimeve të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës dhe Kavajë, si edhe të Gjykatës së Apelit Durrës.

c. Denoncimi me nr. *** prot., datë 24.4.2019, i shtetasit P. R.

Ky denoncim i referohet një subjekt rivlerësimi pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Durrës, për vendimmarrjen lidhur me pushimin e procedimit për një kallëzim penal ndaj një subjekti rivlerësimi, gjyqtar, për “shpërdorim detyre”.

Në këtë denoncim, subjekti i rivlerësimit referohet në cilësinë e drejtueses së Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Durrës, e cila ka firmosur vendimet. Subjekti ka ushtruar funksionin e përfaqësuesit të institucionit dhe nuk ka marrë vendim lidhur me pretendimet e denoncuesit.

ç. Denoncimi me nr. *** prot., datë 24.1.2019, i shtetasit M. K.

Ky denoncim i referohet subjektit të rivlerësimit, si drejtuese e Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, për shkak se ka vonuar në kthimin e një përgjigjeje informacion për një kallëzim penal.

Nga faktet e paraqitura rezulton se Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Durrës i ka kthyer përgjigje denoncuesit, një ditë më vonë dhe është firmosur nga drejtuesi i seksionit me urdhër delegim të Drejtueses së Prokurorisë.

d. Denoncimi me nr. *** prot., datë 2.10.2018, i shtetasit D. H.

Ky denoncim i referohet një subjekti në cilësinë e prokurorit pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Durrës, për vendimmarrje lidhur me bashkimin e procedimeve penale për kallëzim të bërë nga denoncuesi në vitin 2018, kundër një subjekti rivlerësimi, gjyqtar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Nga trajtimi i këtij denoncimi rezulton se subjekti i rivlerësimit nuk ka marrë vendim për bashkimin e procedimeve. Subjekti i rivlerësimit ka sqaruar se në cilësinë drejtueses së prokurorisë ka ushtruar kompetencat ligjore duke sigluar dhe hedhur në short materialet hetimore në të dy rastet e materialeve kallëzuese.

dh. Denoncimi me nr. *** prot., datë 23.10.2018. i shtetasit A. H.

Ky denoncim i referohet tri subjekteve të rivlerësimit. Sipas denoncuesit subjekti ka përkrahur ose konfirmuar vendimin për mosfillimin e procedimit penal si drejtuese e prokurorisë.

Nga dokumentacioni bashkëlidhur denoncimit rezulton se subjekti i rivlerësimit ka ushtruar kompetencat ligjore të përfaqësimit të institucionit si drejtuese prokurorie, nëpërmjet nënshkrimit të shkresës përcjellëse për komunikimin e vendimit për pushimin e procedimit penal nr. *** të vitit 2018 ndaj shtetasit A. H.

e. Denoncimi i shtetasit V. Ç., i cili përcillet në Komision me shkresën nr. *** prot., datë 11.7.2019, të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit. Shtetasi V. Ç., ankohet për subjektin e rivlerësimit, znj. Anita Jella, si dhe për nëntë subjekte të tjerë si të korruptuar dhe të lidhur me botën e krimit të organizuar.

Komisioni, pas analizimit të denoncimit, vlerëson se nuk përmban fakte apo rrethana konkrete që mund të përbëjnë prova në lidhje me kriterin e rivlerësimit në aspektin profesional për subjektin e rivlerësimit.

ë. Denoncimi me nr. *** prot., datë 17.7.2018, i shtetases R. R.

Kjo shtetase ankohet për subjektin e rivlerësimit dhe për pesë subjekte të tjera, pasi nuk kanë hetuar në bazë të ligjit dhe të Kushtetutës.

Komisioni, pas analizimit të denoncimit, vlerëson se nuk përmban fakte apo rrethana konkrete që mund të përbëjnë prova në lidhje me kriterin e rivlerësimit në aspektin profesional për subjektin e rivlerësimit.

f. Denoncimi me nr. *** prot., datë 19.8.2019, i shtetasit V. M. P.

Ky shtetas shprehet se në dhjetor të vitit 2018 ka paraqitur kallëzim penal pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Durrës. Denoncuesi ankohet për subjektin e rivlerësimit, pasi në dhjetor të vitit 2018 ka vendosur të mos hetojë kallëzimin e paraqitur nga ky shtetas dhe i ka transferuar dokumentet në prokurorinë e Tiranës.

Komisioni i është drejtuar me shkresë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Durrës ku i kërkon vendimin e transferimit të kësaj dosjeje në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Tiranë. Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, me shkresën nr. *** prot., datë 10.9.2019, informon se mbi bazën e kallëzimit penal të depozituar pranë kësaj prokurorie nga shtetasi V. M., ndaj noterit publik, S. Sh., anëtar i Dhomës së Noterisë, regjistruarit të ZVRPP-së Durrës dhe shtetasve V. K., V. C., dhe K. M., banues në Tiranë, për veprat penale të parashikuara nga nenet 186 dhe 248 të Kodit Penal, është regjistruar kallëzimi penal me nr. *** , në vitin 2018. Ky kallëzim penal nuk është regjistruar si procedim penal në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, por materiali kallëzues është dërguar për kompetencë në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, pasi referuar nenit 76 të Kodit të Procedurës Penale, trajtimi i kallëzimit penal dhe zgjidhja ligjore është kompetencë e Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Komisioni, pas analizimit të denoncimit, vlerëson se nuk përmban fakte apo rrethana konkrete që mund të përbëjnë prova në lidhje me kriterin e rivlerësimit në aspektin profesional për subjektin e rivlerësimit.

g. Sipas një denoncimi mediatik të datës 18.7.2019, Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës ka dy qëndrime për një çështje, të nënshkruara zyrtarisht njëra nga drejtuesja e saj, subjekti Anita Jella dhe tjetra nga E. K., drejtues i seksionit, me urdhër dhe delegim të drejtueses së prokurorisë. Të dyja shkresat, të cilat japin përgjigje, janë konceptuar prej prokurorit N. T. Sipas artikullit, pas interesimit të shtetasës N. P., në lidhje me kallëzimin penal nr. *** , ndaj shtetasës Z. S., merr dy përgjigje të ndryshme nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Durrës.

Subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar lidhur me këtë denoncim se në datën 28.6.2019 shtetasja N. P., ka depozituar një kërkesë në të cilën kërkon të dhëna në lidhje me kallëzimin penal nr. *** dhe nga prokurori i çështjes N. T., i është kthyer përgjigje me shkresën nr. *** prot., datë 28.6.2019, se Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Durrës e ka regjistruar procedimin penal nr. *** , të vitit 2019, për veprën penale të parashikuar nga neni 245/1 i Kodit Penal. Shkresa është nënshkruar nga shefi i seksionit të krimit ekonomik E. K.

Kërkuesja Z. S., ka drejtuar një kërkesë me anë të së cilës kërkon të informohet nëse në ngarkim të saj është regjistruar ndonjë procedim penal. Me shkresën nr. *** prot., datë 18.7.2019, nga prokurori i çështjes është përpiluar përgjigjja se në ngarkim të kësaj shtetaseje nuk është regjistruar procedim penal në këtë prokurori.

Nga prokurori i çështjes bëhet me dije se kallëzimi i shtetasës N. P., ka pasur për objekt dy kërkesa, konkretisht për veprën penale shpërdorimit të detyrës, vepër kjo e parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal ndaj shtetasës Z. S., dhe ndaj shtetasit I. A., i cili është kallëzuar nga kjo shtetase për veprën penale “ushtrim të ndikimit të paligjshëm ndaj personave që ushtrojnë funksione publike”, parashikuar nga neni 245/1, i Kodit Penal. Prokurori, pasi ka studiuar këtë material kallëzues, ka vendosur regjistrimin e procedimit penal për veprën penale “ushtrim të ndikimit të paligjshëm ndaj personave që ushtrojnë funksione publike”, parashikuar nga neni 245/1, i Kodit Penal.

Në vijim, të dyja këto përgjigje, lëshuar nga kjo prokurori, sipas kërkesave përkatëse për informim të të dy shtetaseve të sipërcituara, kanë përmbajtje të vërtetë.

58. Në vijim të procesit të rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit, në datën 3.10.2019 në Komision erdhi një denoncim anonim. Ky denoncim u pasua në ditët e vijueshme edhe me shkrime në portale *online*. Komisioni, i mbështetur edhe në kërkesën e bërë nga Operacioni Ndërkombëtar i Monitorimit, vendosi të verifikojë të gjitha *indiciet* e referuara në denoncimin anonim, edhe ato të shpërndara mediatikisht.

➤ **Mbi informacionin e marrë nga portali *pamfleti.net*⁸**

1. Mbylli dosjen e shtetasit D. M., ***, nuk kërkonte arrestimin e tij, megjithëse e kishte shpallur në kërkim dhe ai vazhdonte të firmoste tendera, emërime dhe mes tyre edhe borderonë e punonjësve, ku punojnë edhe 3 familjarë të prokurores Anita Jella.

→ Komisioni, me shkresën nr. *** prot., datë 8.10.2019, i ka kërkuar Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Durrës, dosje të fashikujve përkatës për procedime penale ndaj shtetasit D. M.

A. Me shkresën nr. *** prot., datë 18.10.2019, Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës informon se prokurorja Anita Jella ka pasur në hetim çështjen penale nr. ***, të vitit 2017, e cila është dërguar për gjykim për veprën penale të parashikuar nga neni 190 i Kodit Penal. Bashkëngjitur prokuroria vendos në dispozicion kopje të fashikullit.

Nga shqyrtimi i dosjes nr. ***, të vitit 2017, rezulton se në datën 14.2.2017, në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Durrës është dërguar nga Prokuroria e Përgjithshme materiali për hetime të mëtejshme për shtetasin D. M., *** në “***”, Durrës.

Në datën 27.10.2017 Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Durrës ka paraqitur në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës, kërkesën për dërgimin e çështjes penale për gjykim nr. ***, të vitit 2017, në ngarkim të të pandehurit D. M., akuzuar për kryerjen e veprës penale “falsifikim i vulave, stampave ose i formularëve”, të parashikuar nga neni 190/1⁹.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës, me vendimin nr. ***, datë 15.12.2017, ka vendosur pushimin e çështjes penale.

Subjekti i rivlerësimit ka paraqitur ankim kundër vendimit të pushimit në datën 27.12.2017.

Gjykata e Apelit Durrës vendosi ndryshimin e vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës dhe dërgimin për gjykim të procedimit penal nr. ***/2017.

Subjekti, gjatë hetimit administrativ, shpjegon se pasi Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës me vendimin nr. ***, datë 15.12.2017, kishte vendosur pushimin e çështjes penale në ngarkim të të pandehurit D. M., ka paraqitur ankim dhe Gjykata e Apelit Durrës me vendimin nr. ***, datë 29.3.2018, ka vendosur ndryshimin e vendimit penal nr. ***, datë 15.12.2017, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, si më poshtë: “*Dërgim për gjykim të procedimit penal nr. ***/2017, në ngarkim të të pandehurit D. M., i akuzuar për veprën penale të parashikuar nga neni 190/1, i Kodit Penal në dhomën penale të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës*”.

Gjykata e Apelit ka vendosur dërgimin në gjyq të çështjes në dhomën penale të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, dhe nuk ka vendosur vazhdimin e hetimeve.

Subjekti bashkëngjijt, ndër të tjera, përgjigjen e Gjykatës së Apelit Durrës, nga ku rezulton se ndaj vendimit të Gjykatës së Apelit është ushtruar rekurs nga z. D. M., dhe pas ezaurimit të procedurave të komunikimit të rekursit, në datën 28.5.2018, dosja është dërguar në Gjykatën e Lartë.

⁸ <https://pamfleti.net/anita-jella-krje-prokurorja-e-Durresit-qe-prej-17-vitesh-peqehet-nga-krimi-a-jane-futur-keto-17-njolla-ne-dosjen-e-veting/>

⁹ Në formularin e vetëdeklarimit të plotësuar në kuadër të ligjit të dekrimalizimit në vitin 2016 z. D. M., ka deklaruar të dhëna të rreme, pasi nuk ka treguar dënimin në vitin 2006. Me vendimin nr. ***, datë 24.2.2006, z. D. M., është deklaruar fajtor për kryerjen e veprës penale “mashttrim në sigurime”, parashikuar nga neni 145 i Kodit Penal dhe është dënuar me gjobë 100.000 (njëqind mijë) lekë. Kundër këtij vendimi është ushtruar ankim dhe Gjykata e Apelit Durrës ka vendosur mospranimin e ankimit të të pandehurit D. M.

➤ **Në përfundim, trupi gjykues vlerëson se pretendimi i ngritur në portal nuk qëndron dhe se subjekti i rivlerësimit ka kërkuar dërgimin për gjykim të procedimit penal.**

B. Për shtetasin D. M., sipas shkresës nr. *** prot., datë 18.10.2019, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës, ka edhe një procedim tjetër penal me nr. ***, i vitit 2017, për veprën penale të parashikuar nga neni 199/a/3 i Kodit Penal (ndërtim i paligjshëm), procedim penal i cili është hetuar nga prokurorët O. Rr., S. B., dhe aktualisht është në hetim nga prokurorë E. P. Ky procedim nuk ndiqet nga subjekti i rivlerësimit.

Subjektit të rivlerësimit, nisur nga denoncimi mediatik, i janë kërkuar shpjegime, duke bashkëlidhur dokumentacionin përkatës, për sa më poshtë:

- a) A ka qenë “person të cilit i atribuohet vepra penale”, “personit ndaj të cilit zhvillohen hetime” dhe “i pandehur” dhe a është shpallur në kërkim shtetasi D. M., në cilësinë e funksionarit publik si *** nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës, nëse po, na informoni duke vendosur në dispozicion dokumentacionin ligjor provues?
- b) Ju lutem të informoni Komisionin nëse keni pasur apo keni familjarë tuaj të punësuar në shoqërinë “***” sh.a. Durrës, si dhe kohën e punësimit të tyre në këtë institucion.

Subjekti i rivlerësimit shpjegon sa vijon:

- a) Për t’i dhënë përgjigje pyetjeve të Komisionit i jam drejtuar zyrës së regjistrimit e cila, në përgjigjen e datës 25.11.2019, më informon se: “Në lidhje me shtetasin D. M. M., i datëlindjes ***, sqarojmë se:
 - Lidhur me procedimin penal nr. ***, datë 26.7.2017, për veprën penale të parashikuar nga nenet 248 dhe 328 të Kodit Penal, referuar nga Zyra e Kryeministrit ndaj *** sh.a., është marrë vendimi i dërgimit të çështjes për pushim në datën 20.2.2018 (328 dh), në të cilin shtetasi i sipërpërmendur nuk ka qenë person nën hetim (bashkëlidhur urdhër regjistrimi i procedimit penal nr. ***/2017).
 - Lidhur me procedimin penal nr. ***, datë 15.2.2018, i cili është në hetim për veprat penale të parashikuar nga nenet 248, 259, 199/a-3, shtetasi i sipërpërmendur është nën hetim në lidhje me veprën penale të parashikuar nga neni 199/a-3 (vepër e cila nuk lidhet me detyrën e tij si ish-zyrtar), (bashkëlidhur urdhër regjistrim, emër personi, që i atribuohet vepra penale datë 23.2.2018, si dhe urdhër regjistrim i procedimit penal nr. ***, datë 26.2.2018)
- b) Lidhur me këtë denoncim, informoj Komisionin me përgjegjësi të plotë se asnjë nga familjarët e mi nuk ka qenë dhe nuk është i punësuar në shoqërinë “***” sh.a. Durrës.

2. Me vendimin e saj, zhbllokoi pallatin tek ***, ndërtuar 6 metër pranë paretit anësor të autostradës, megjithëse ishte bllokuar për sekuestro dhe shkatërrim, nga kolegja e saj O. Rr., faktuar dhe nga drejtori i Urbanistikës, Bashkia Durrës, A. Q., pjesë e pazarit.

3. Vanoi dhe pushoi çështjen e dosjes për lejet e paligjshme brenda zonës së mbrojtur në Durrës, dhënë nga Drejtori i Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, Bashkia Durrës.

Subjekti i rivlerësimit shpjegon¹⁰ se procedimi penal mbi ndërtimin e paligjshëm tek *** nuk është mbyllur, por hetimet vazhdojnë dhe ndiqen nga prokurori A. Sh. Subjekti bashkëlidh vërtetimin nr. *** prot., datë 4.10.2019, sipas të cilit Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës ka regjistruar procedimin penal nr. ***, datë 13.2.2018, për veprën penale të parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal, në ngarkim të shtetasit A. Q., mbi dhënien e një lejeje ndërtimi në zonën e ***. Në lidhje me këtë çështje hetimi vazhdon.

Komisioni, me shkresën nr. *** prot., datë 8.10.2019, i ka kërkuar Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Durrës kopjen e fashikullit që i përket procedimit penal lidhur me ndërtimin e paligjshëm tek vendi i quajtur ***, nëse çështja është e regjistruar në procedim e sipër, është kërkuar informacion mbi statusin e çështjes.

¹⁰ Me e-mail-in e datës 4.10.2019.

Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës, me shkresën nr. *** prot., datë 18.10.2019, informon se lidhur me procedimin penal për ndërtim të paligjshëm tek vendi *** është regjistruar procedimi penal nr. ***, i vitit 2018, për veprat penale të parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal. Bashkëngjitur dërgohet një informacion i prokurorit të çështjes, si dhe një kopje e vendimit të gjykatës.

Sipas informacionit të datës 17.10.2019 të Prokurorit A. Sh., pas referimit të ardhur nga Drejtoria Vendore e Policisë Durrës kjo prokurori ka regjistruar procedimin penal nr. ***, datë 13.2.2018, për veprën penale “shpërdorim detyre”.

Në datën 8.3.2018 është regjistruar emri i shtetasit A. Q., me detyrë drejtor i Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit në Bashkinë Durrës si person që i atribuohet kjo vepër.

Nga hetimi ka rezultuar se me vendimet e datës 17.2.2017 dhe datës 4.8.2018 është miratuar leje zhvillimi dhe ndërtimi në pasurinë që gjendet në lagjen ***, ***, Durrës, për objektin “hotel, shërbime turistike dhe zyra, dyqane me shumicë dhe pakicë, dyqane, zyra publike dhe private”, në pronësi të shtetasit N. D.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës, me vendimin nr. ***, datë 13.3.2018, ka vendosur, ndër të tjera:

- a. Pezullimin e kryerjes së mëtejshme të punimeve të ndërtimit në objektin “hotel 5-6 kate dhe 1 kat nëntokë”.
- b. Pezullimin e kryerjes së transaksioneve regjistruar në pronësi të shtetasit N. D.

Në funksion të hetimit është kryer një ekspertim teknik hortografik nga ing. B. L., në nëntor të vitit 2018, në konkluzionet e të cilit rezulton se:

- a. Sipas matjeve faktike në terren të objektit të ndërtuar fizikisht rezulton se është ndërtuar në përputhje me lejen, për shkak të një rrotullimi të vogël.
- b. Sheshi i ndërtimit është pozicionuar në zonën e përcaktuar si zonë turistike dhe detare, miratuar nga Këshilli Kombëtar i Territorit.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës, me vendimin nr. ***, datë 27.12.2018, mbi kërkesën e z. N. D., ka vendosur heqjen e masës së sigurimit, sekuestro preventive.

Sipas vendimit të gjykatës së sipërcituar prokuroria ka kërkuar pranimin pjesërisht të kërkesës për lejimin e kryerjes së punimeve të ndërtimit në objektin “hotel 5-6 kate dhe 1 kat nëntokë”, ndërsa në lidhje me pezullimin e transaksioneve duhet të vazhdojë për shkak se ka nevojë të kryhen hetime në lidhje me legalizimin e truallit dhe bashkimin e pasurive.

Në vendimin e gjykatës citohet: *“Në gjykimin e kërkesës për heqjen e masës së sekuestros gjykata në seancë gjyqësore pyeti përfaqësuesin e prokurorisë në lidhje me ecurinë e procedimit penal të regjistruar në emër të shtetasit A. Q., dhe nga ana e tij u konfirmua se hetimet janë kryer dhe se do të procedohet duke depozituar në gjykatë kërkesën për pushimin e hetimeve ndaj z. A. Q., pasi nuk rezultuan elementë të shpërdorimit të detyrës”.*

Sipas informacionit të prokurorit gjatë hetimit të këtij procedimi penal, me shkresën nr. ***, datë 24.7.2019, të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit Tiranë ka *indicie* edhe për veprën penale “pastrim i produkteve të veprës penale”, të parashikuar nga neni 287, i Kodit Penal. Ky procedim penal është në hetim.

Komisioni, me shkresën nr. *** prot., datë 25.10.2019, i kërkoi Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Durrës informacion mbi procedurën e ndjekur lidhur me kërkesën për pushimin e hetimeve për procedimin penal, si dhe rolin e subjektit në ushtrimin e kompetencave që i jep ligji lidhur me ecurinë e këtij procedimi penal.

Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, me shkresën nr. *** prot., datë 30.10.2019, dërgon informacionin e prokurorit të çështjes mbi procedurën e ndjekur prej tij dhe arsyen përse ky procedim është ende në hetim.

Nga informacioni i prokurorit A. Sh., datë 29.10.2019 mbi ecurinë e procedimit penal nr. ***, datë 13.2.2018, rezulton se nuk ka një procedurë të ndjekur lidhur me kërkesën e pushimit të hetimeve për procedimin penal në ngarkim të shtetasit A. Q., për shkak se duheshin kryer hetime të tjera, të cilat nuk lidhen me heqjen e sekuestros dhe veprimet e shtetasit A. Q., por me hetimin mbi një shtetas tjetër.

Prokurori, ndër të tjera, shpjegon se për të mos dëmtuar dhe paragjykuar hetimet nuk është proceduar me kërkesën për pushimin e hetimeve në ngarkim të shtetasit A. Q.

Gjithashtu, në shkresën e saj Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Durrës informon se për sa i përket rolit të drejtueses subjekti nuk ka pasur rol në ecurinë e këtij procedimi penal në ushtrim të kompetencave që i jep ligji. Shkresat përcjellëse për kërkesën për sekuestro preventive dhe pezullimin nga detyra të shtetasit A. Q., rezultojnë të jenë nënshkruar nga drejtuesi i mëparshëm.

Subjekti i rivlerësimit, lidhur me këtë denoncim, ka shpjeguar se: *“Ashtu siç pasqyrohet në shpjegimet e dhëna nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës të sipërcituara, unë kam pasur detyrën e drejtueses së prokurorisë në kohën kur nga Gjykata e Shkallës së Parë Durrës është vendosur heqja e masës së sekuestros preventive për ndërtimin objekt hetimi në çështjen e ndjekur nga prokurori A. Sh. Dua të sqaroj se kërkesa për heqjen e sekuestros është paraqitur në gjykatë nga shtetasi N. D., pronar i objektit në ndërtim dhe jo nga prokuroria. Prokuroria ka marrë pjesë në gjykimin e çështjes mbi bazën e njoftimit të përcjellë nga gjykata, njoftim i cili i është dërguar prokurorit konkret që ndjek çështjen në hetim, pasi është ky prokurori që në bazë të nenit 24/1 dhe 277 të Kodit të Procedurës Penale përfaqëson ipso jure organin e prokurorisë në gjykatë për çdo kërkesë të palëve të interesuar në fazën e hetimit të çështjes penale që ai ka në hetim. Në këto raste, prokurori i çështjes parashtron qëndrimin e tij mbi kërkesat e palëve të interesuara në mënyrë të pavarur në seancë gjyqësore, nisur nga bindja e tij e brendshme e krijuar nga provat e marra në seancë gjyqësore dhe ecuria e procedimit penal, që dihet prej tij si prokurori i hetimit. Prokurori i seancës ka qenë gjithmonë i pavarur lidhur me mendimin e dhënë prej tij në seancë gjyqësore, garanci që ishte e parashikuar shprehimisht edhe në nenin 25/3 të Kodit të Procedurës Penale para se të ndryshohej me ligjin nr. 35/2017. Aktualisht pavarësia e prokurorit është zgjeruar pasi në bazë të nenit 25/2 të Kodit të Procedurës Penale, të ndryshuar, është shfuqizuar parashikimi, që e kufizonte pavarësinë e prokurorit vetëm në seancë gjyqësore, duke e njohur këtë pavarësi gjatë gjithë ushtrimit të funksioneve të prokurorit. Një gjë e tillë është reflektim të parashikimeve të Kushtetutës së Shqipërisë. Nisur nga sa më sipër, rezulton se qëndrimi i mbajtur nga prokurori në gjykatë për heqjen e sekuestros ka qenë produkt vetëm i mendimit të tij të pavarur si prokuror i çështjes. Në respektim të pavarësisë së prokurorit të çështjes të garantuar në Kushtetutë dhe nenet 25 dhe vijues të Kodit të Procedurës Penale, unë si drejtuese e prokurorisë nuk kam dhënë asnjë mendim ose sugjerim paraprak për këtë çështje. Prokurori i çështjes nuk më ka kërkuar ndonjë mendim lidhur me qëndrimin që ai do të mbante në seancë. Në lidhje me këtë çështje kam marrë dijeni vetëm pas zhvillimit të seancës gjyqësore nga prokurori i çështjes. Si drejtuese e prokurorisë nuk kam asnjë kompetencë ligjore që të apeloj vendimin e gjykatës, për heqjen e masës së sekuestros preventive për ndërtimin. Pas ardhjes në dijeni të gjykimit të çështjes për heqjen e sekuestros, kam komunikuar me prokurorin e çështjes A. Sh., të cilin në bazë të ligjit organik, i kam kërkuar vazhdimin më tej të hetimeve të çështjes. Kjo çështje është ende në hetim.”*

4. Mbylli dosjen e korrupsion-falsifikimeve të drejtorit të ALUIZNI-t Durrës, A. I., shpallur në kërkim dhe fshirë padia penale, duke ia hequr dosjen prokurorit S. N., e dhënë pa short prokuror-sekserit të saj N. T., i cili e nxori të pastër dhe në liri.

Subjekti, për sa i përket shtetasit A. I.¹¹, sqaron se masa e sigurimit ndaj këtij shtetasi është vendosur në muajin gusht, kur ajo ka qenë me pushime. Znj. Anita Jella shpjegon se bazuar në

¹¹ Me e-mail-in e datës 4.10.2019.

ligjin për prokurorinë, me ndryshimet e fundit, drejtuesi i prokurorisë nuk ka asnjë rol në caktimin e masave të sigurimit, pasi vendos vetë prokurori i çështjes.

Subjekti vendosi në dispozicion të Komisionit kërkesën e datës 13.8.2019, drejtuar Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës “Për vlerësimin e ligjshëm të ndalimit dhe caktimin e masës së sigurimit në ngarkim të shtetasve A. I. etj”, të firmosur me urdhër dhe delegim nga shefi i seksionit E. K.

Komisioni, me shkresën nr. *** prot., datë 8.10.2019, i ka kërkuar Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Durrës kopjen e fashikujve që i përkasin procedimeve penale në ngarkim të shtetasve F. Gj., dhe A. I., për legalizime kur këta shtetas kanë qenë drejtues në zyrën e ALUIZNI-t Durrës.

Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, me shkresën nr. *** prot., datë 18.10.2019, bën më dije se ka një procedim penal në ngarkim të shtetasit A. I., (nr. *** , i vitit 2019), regjistruar për veprën penale të parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal, i cili hetohet nga prokurori N. T. Bashkëngjitur dërgohet informacioni i prokurorit të çështjes dhe shkresa përcjellëse e masave të sigurimit në gjykatë. Sipas informacionit të prokurorit N. T., Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës në datën 11.8.2019 ka regjistruar procedimin penal nr. *** , të vitit 2019, në ngarkim të shtetasve A. I., etj., si persona të dyshuar për kryerjen e veprave “shpërdorim detyre”, e kryer në bashkëpunim dhe “falsifikim i dokumenteve”, të parashikuara nga nenet 248-25 dhe 186 i Kodit Penal. Procedimi ndodhet në fazën e hetimit.

Subjekti¹² ka shpjeguar lidhur me procedimin penal në ngarkim të shtetasit A. I., etj., duke informuar se gjatë muajit gusht, konkretisht në datën 9.8.2019 prokurori A. N., ka qenë i gatshëm, mbi bazën e kallëzimit penal të shtetasit F. M., ka kryer veprime hetimore dhe ka nxjerrë urdhra ndalimi për pesë shtetas, pa regjistruar procedim penal, si dhe pa shkresë përcjellëse të prokurorisë, nga të cilat në momentet e para janë ekzekutuar vetëm dy prej tyre.

Në datën 11.8.2019, në të cilën ka qenë i gatshëm prokurori S. N., sipas grafikut të gatishmërisë, është vijuar me regjistrimin e procedimit penal dhe përpilimin e kërkesave për vleftësimin e ndalimeve të kryera dhe caktimin e masave të sigurimit për katër të ndaluar. Subjekti sqaron se gjatë muajit gusht prokurorët kryejnë të gjitha veprimet e ngutshme në datat e gatishmërisë së tyre, por gjithashtu nuk ka pengesë të vazhdojnë t’i kryejnë vetë dhe jashtë ditëve të gatishmërive përkatëse.

Gjatë muajit gusht, konkretisht në datën 28.8.2019, ka qenë i gatshëm prokurori N. T., dhe nga policia gjyqësore është ekzekutuar një urdhër ndalimi i nxjerrë që në fillim të gushtit në kuadër të këtij procedimi penal. Për këtë shkak është kërkuar vleftësimi i ndalimit dhe caktimi i masës së sigurimit personal nga ky prokuror.

Në datën 12.9.2019 prokurori S. N., i cili bën pjesë në Seksionin e Krimit të Përgjithshëm, ka paraqitur kërkesa për zëvendësimin e tij, pasi procedimi penal ishte regjistruar për veprat penale të cilat ndiqeshin në hetim nga Seksioni i Krimit Ekonomik.

Referuar faktit se nga prokurori N. T., i cili bën pjesë në Seksionin e Krimit Ekonomik, ishte trajtuar një ndalim, pra, një veprim urgjent, subjekti vendosi zëvendësimin e prokurorit S. N., me prokurorin N. T.

Subjekti sqaron gjithashtu se sipas urdhrit me nr. *** , datë 31.7.2019, që është në fuqi, prokurori A. N., bën pjesë në Seksionin e Krimit të Përgjithshëm.

Të tre këta prokurorë kishin kryer veprime urgjente gjatë muajit gusht: prokurori A. N., kishte nxjerrë urdhrat e ndalimit; prokurori S. N., ka regjistruar procedimin penal dhe ka kërkuar vleftësimin e ndalimeve dhe caktimin e masave të sigurimit për disa prej të ndaluarve; prokurori N. T., ka trajtuar kërkesën për vleftësimin e ndalimit dhe caktimin e masave të

¹² Shihni përgjigjet e e-mail-it të datës 5.11.2019.

sigurimit për një të ndaluar, veprime të kryera në kuadër të këtij procedimi penal. Subjekti deklaroi se rregulli që zbatohet në këto raste, ashtu siç vepron në të gjitha prokuroritë dhe gjykatat në Republikën e Shqipërisë, është respektuar edhe nga ana e saj në zëvendësimin e prokurorit të këtij procedimi penal, duke caktuar njërin nga prokurorët që kishte trajtuar veprime urgjente të dosjes, pra, njëhte dosjen dhe që bën pjesë në Seksionin e Krimit Ekonomik, ndarje kjo referuar veprave penale për të cilat është regjistruar procedimi penal.

Subjekti shprehet se baza ligjore për kryerjen e këtij zëvendësimi është si më poshtë:

- a. Prokurori që ka regjistruar procedimin penal, S. N., ka paraqitur kërkesë për zëvendësim, referuar nenit 27, pika 1, të Kodit të Procedurës Penale.
- b. Ky procedim penal është regjistruar për veprën penale “shpërdorim detyre”, parashikuar nga neni 248 të Kodit Penal, vepër kjo që referuar urdhrit nr. ***, datë 23.1.2018 (i cili është ende në fuqi), ndiqet nën hetim nga Seksioni i Krimit Ekonomik.
- c. Çështja është përjashtuar nga shorti, pasi njëri prej tre prokurorëve që kishin trajtuar veprime urgjente për dosjen, ishte edhe prokuror i Seksionit të Krimit Ekonomik dhe e njëhte këtë procedim penal, bazuar në Udhëzimin e Prokurorit të Përgjithshëm me nr. ***, datë 29.12.2016, pika 2, germa “b”.

Subjekti ka vendosur në dispozicion të Komisionit: kopje të njehsuara me origjinalin të kërkesës për zëvendësim dhe vendimit të zëvendësimit të prokurorit S. N.; kopje të urdhrave për ndarjen në seksione dhe shpërndarjen e çështjeve në prokurori; kopje të grafikut të gatshmërisë së muajit gusht; kopje të urdhrit për shpërndarjen e çështjeve për periudhën e pushimeve vjetore të muajit gusht; udhëzim nr. ***, datë 23.01.2018; si dhe urdhrat mbi organizimin e punës sipas seksioneve dhe ndarjen prokuror-oficer të policisë gjyqësore.

Vëzhguesi ndërkombëtar ka paraqitur opinion me nr. *** prot., datë 14.11.2019, sipas të cilit përfshirja e tre prokurorëve të ndryshëm në fazat fillestare të hetimit, edhe pse bëhet fjalë për muajin gusht, nuk tregon menaxhim të duhur të burimeve të institucionit dhe të sistemit të gatshmërisë, pasi modalitete si ato, të ndodhura në çështjen e sipërpërmendur mund të çojnë, përfundimisht në dëmtim të vetë hetimit.

Në lidhje me këtë opinion të vëzhguesit ndërkombëtar, subjekti i rivlerësimit, ndër të tjera, ka shpjeguar: *“Në këtë kuadër, natyra e veprimeve procedurale, të kryera nga tre prokurorët në periudhën e gatshmërisë, nuk mund të ndikojë negativisht në ecurinë e hetimeve, për më tepër kur të gjitha këto veprime procedurale kanë të bëjnë me vlerësimin e ndalimeve dhe caktimin e masave të sigurimit. Prokurori S. N., është prokurori që ka vijuar me regjistrimin e materialit dhe kryerjen e veprimeve urgjente hetimore, pasi prokurori A. N., nuk i kishte kryer ato, edhe pse kishte pasur detyrimin për t’i kryer. Pra, nuk mund të konsiderohet një çështje e filluar kryesisht, e cila, referuar ligjit nr. 97/2016 duhet të hetohet nga prokurori i cili e ka filluar atë.*

*Përfshirja e tre prokurorëve në çështjen penale nr. ***, të vitit 2019, është shkaktuar nga disa urdhra ndalimi që prokurori A. N., kishte nxjerrë për disa persona në periudhën e tij të gatshmërisë në muajin gusht. Sqarohet se njëri prej tyre është ekzekutuar menjëherë. Edhe pse ekzekutimi i urdhrit të ndalimit është bërë në ditën që prokurori që e ka nxjerrë, ka qenë vetë i gatshëm, nga ana e tij nuk është kryer asnjë veprim lidhur me të dhe nuk është bërë nga ana e tij kërkesa për vleftësimin e ndalimit në gjykatë. Ndodhur në këto kushte, prokurori që ka qenë i gatshëm ditën pasuese, konkretisht, S. N., ka qenë i detyruar që të kërkonte vleftësimin e ndalimit në gjykatë. Gjithashtu, disa prej urdhrave të tjerë të ndalimit janë ekzekutuar nga policia gjyqësore në kohën kur i gatshëm ishte prokurori S. N.”*

5. Pushoi hetimet për djegien e arkivës, dosjet ekonomike-financiare të Bashkisë Durrës, të ndodhur në datën 6.7.2019.

Komisioni, me shkresën nr. *** prot., datë 8.10.2019, i ka kërkuar Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Durrës informacion lidhur me çështjen penale “djegia e arkivës së Bashkisë Durrës”.

Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës, me shkresën nr. *** prot., datë 18.10.2019, lidhur me çështjen penale “djegia e arkivës së Bashkisë Durrës”, bën me dije se është regjistruar një material hetimor me nr. ***, datë 9.7.2019, për veprën penale të parashikuar nga neni 151 i Kodit Penal, për të cilin nga prokurori i çështjes A. Sh., është vendosur mosfillimi i procedimit. Bashkëngjitur është vendosur në dispozicion një kopje e këtij mosfillimi.

Sipas vendimit të mosfillimit të procedimit datë 18.7.2019, të prokurorit A. Sh., prokuroria, mbi bazën e materialit të dërguar në datën 9.7.2019 nga Komisariati i Policisë Durrës, ka regjistruar kallëzimin penal nr. ***.

Nga materiali kallëzues rezulton se në datën 6.7.2019, rreth orës 20:00 shërbimet e policisë kanë marrë njoftim se në godinën e bashkisë ka rënë zjarr. *Nga akti i ekspertimit piroteknik nr. ***, datë 18.7.2019, rezulton se vatra e zjarrit është te kutia shpërndarëse e energjisë elektrike dhe se shkak ka qenë shkëndija elektrike brenda kutisë.* Nga informacioni i OPGJ-së, datë 8.7.2019, mbi referimin e veprës penale, konstatohet se zjarri nuk ka dalë jashtë kutisë.

Komisioni konstatoi se nuk qëndron pretendimi i ngritur në artikull, ky procedim nuk është hetuar nga subjekti i rivlerësimit dhe ajo nuk ka pasur ndonjë rol në këtë çështje.

6. Pushoi hetimin për auditimin e KLSH-së në Bashkinë Durrës, ku bëhej fjalë për abuzimet me vlerë 11 milionë euro taksa, buxhet, tendera, qira objektsh, shitje pasurore, të ardhura legalizimesh e lejesh ndërtimi, bërë nga motra e shtetasit V. D., shtetasja V. Q., 11 vjet drejtore e financë-prona në bashki.

Komisioni, me shkresën nr. *** prot., datë 8.10.2019, i ka kërkuar Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Durrës të dërgojë dosjen lidhur me ecurinë e procedimit të filluar mbi auditimin e KLSH-së në Bashkinë Durrës, në ngarkim të shtetasës V. Q.

Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës, me shkresën nr. *** prot., datë 18.10.2019, informon se lidhur me auditimin e KLSH-së në Bashkinë Durrës, në ngarkim të shtetasës V. Q., nga kërkimet e kryera nga zyra e regjistrimit nuk rezulton të ketë pasur kallëzime apo procedime penale në ngarkim të kësaj shtetaseje.

Komisioni i ka kërkuar informacion Kontrollit të Lartë të Shtetit¹³ nëse ka dërguar në Prokurorinë e Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës raportin e auditimit të kryer në Bashkinë Durrës.

Komisioni i ka kërkuar shpjegime subjektit nëse raporti i auditimit të KLSH-së mbi Bashkinë Durrës i është dërguar ndonjëherë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Durrës nga KLSH-ja, ose nëse raporti i policisë për këtë çështje i është transferuar Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Durrës. Nëse po, subjekti të shpjegojë çfarë është bërë me këtë raport auditimi dhe/ose raportin e policisë.

Subjekti sqaron se si prokurore nuk ka hetuar asnjëherë çështje penale që kanë të bëjnë me kallëzime të KLSH-së dhe bashkëlidh përgjigjen “informacion i zyrës së regjistrimit në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Durrës”.

7. Bashkë me shtetasit D. P., A. M., N. T., dhe A. Sh., inskenoi dy herë grabitjen e dosjeve “VIP” të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Durrës, një herë duke sulmuar postierin dhe një herë duke shqyer zyrat natën, dmth., vetëm zyrat ku ishin dosjet që duheshin zhdukur dhe ishin lënë gati mbi tavolinë.

Subjekti i rivlerësimit ka dhënë shpjegime lidhur me këtë informacion ku, ndër të tjera, citon: *“Ky denoncim është tërësisht një trillim i pabazuar dhe qesharak. Të dyja këto ngjarje kanë qenë tronditëse, jo vetëm për mua, por për të gjithë prokurorët dhe punonjësit e tjerë të Prokurorisë së Durrësit.”*

¹³ Shihni shkresën nr. *** prot., datë 6.11.2019.

Subjekti ka sjellë bashkëngjitur urdhrat, udhëzimet dhe aktet e tjera lidhur me masat e marra për këtë rast.

8. Bashkë me shtetasen D. P., solli vërdallë dosjen e hetimit të shkurtit të vitit 2018 “A. Ç.”, për 613 kilogramë kokainë, të kapura në Maminas, duke e vonuar me “gjoja kompetenca” dhe duke zhdukur prova.

Komisioni, me shkresën nr. *** prot., datë 8.10.2019, i ka kërkuar Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Durrës të dërgojë kopjen e fashikullit që i përket procedimit penal lidhur me dosjen e shkurtit të vitit 2018, të shtetasit A. Ç., për hetimin e 613 kilogramë kokainë, të kapura në Maminas.

Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës, me shkresën nr. *** prot., datë 18.10.2019, bën me dije se nga të dhënat e bëra publike për këtë rast, ky procedim penal është filluar nga Prokuroria për Krime të Rënda Tiranë dhe në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Durrës nuk ka qenë asnjëherë i regjistruar kallëzim apo procedim penal për këtë rast.

Komisioni ka vlerësuar se nuk qëndron pretendimi i ngritur në artikull dhe se subjekti nuk ka pasur asnjë rol.

9. Nxori të pastër dosjen për kamionin me 8 tonë kanabis, të transportuar me letra të agjencinë doganore “****”, të bashkëshortes së z. Q. S.

Komisioni, me shkresën nr. *** prot., datë 8.10.2019, i ka kërkuar Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Durrës të dërgojë dosjen lidhur me ecurinë e procedimit të filluar mbi subjektin agjencia doganore “****”.

Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës, me shkresën nr. *** prot., datë 18.10.2019, lidhur me kërkesën për procedim penal të filluar mbi subjektin agjencia doganore “****”, informon se në datën 21.2.2017 është regjistruar procedimi penal nr. ****, i vitit 2017, i cili është hetuar nga prokurori B. B., dhe se në datën 13.2.2018 është shpallur moskompetenca dhe kalimi i akteve Prokurorisë për Krime të Rënda. Bashkëngjitur janë vendosur në dispozicion një kopje e vendimit të shpalljes së moskomptencës dhe shkresa përcjellëse e firmosur nga drejtuesja D. P.

Komisioni vlerëson se nuk qëndron pretendimi i ngritur në artikull, pasi sipas informacionit të administruar ky procedim është dërguar për kompetencë në Prokurorinë për Krime të Rënda dhe se subjekti nuk ka pasur rol në këtë çështje.

10. Në pazar me shtetasin V. D., dhe gjyqtarin A. V., firmosi me “ok” dosjen e lirit nga burgu të shtetasit L. B.

Komisioni, me shkresën nr. *** prot., datë 8.10.2019, i ka kërkuar Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Durrës të jepte sqarime mbi pozicionin e subjektit në dosjen penale të shtetasit L. B., që përfundoi me lirim e tij nga burgu.

Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës, me shkresën nr. *** prot., datë 18.10.2019, informon se prokurorja Anita Jella nuk ka marrë pjesë në asnjë nga seancat gjyqësore për shqyrtimin e kërkesave të këtij shtetasi për lirim para kohe me kusht. Po kështu, informon se kjo prokurore nuk ka qenë as në rolin e drejtueses së prokurorisë për rastin në fjalë. Bashkëngjitur është vendosur në dispozicion një kopje e praktikës së lirit të këtij të dënuari.

Në këtë praktikë gjendet shkresa nr. *** prot., datë 5.12.2016, e Prokurorisë pranë Gjykatës së Apelit Durrës, për dërgimin e urdhër-ekzekutimit të vendimit nr. ***, datë 5.12.2016, të Gjykatës së Apelit Durrës ndaj kërkuarit L. B., së bashku me vendimet gjyqësore.

Komisioni vlerëson se nuk qëndron pretendimi i ngritur në artikull, pasi sipas informacionit të administruar subjekti i rivlerësimit nuk ka marrë pjesë në asnjë nga seancat gjyqësore për

shqyrtimin e kërkesave të këtij shtetasi për lirim para kohe me kusht dhe nuk ka qenë në rolin e drejtueses së prokurorisë.

11. Ka firmosur pushimin e çështjes “trualli i hotel ‘****’”, dosje ku ishin të përfshirë edhe dy drejtorë hipotekash.

Komisioni, me shkresën nr. *** prot., datë 8.10.2019, i ka kërkuar Prokurorisë së Rrethit Gjiqësor Durrës të dërgonte fashikullin që i përket procedimit penal lidhur me çështjen “trualli i hotel ‘****’”.

Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës, me shkresën nr. *** prot., datë 18.10.2019, lidhur me çështjen “trualli i hotel ‘****’”, informon se në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës është regjistruar një procedim penal me nr. **, të vitit 2014, i cili është ndjekur në hetim nga prokurorët E. P., dhe A. Gj., ku më pas, në datën 22.4.2016 është shpallur moskompetenca dhe çështja i ka kaluar për hetim Prokurorisë për Krime të Rënda Tiranë. Bashkëngjitur është vendosur në dispozicion urdhër-regjistrim procedimi dhe shkresa përcjellëse e moskompetencës.

Komisioni vlerëson se nuk qëndron pretendimi i ngritur në artikull, pasi sipas informacionit të administruar çështja nuk është pushuar, por i ka kaluar për hetim Prokurorisë për Krime të Rënda Tiranë dhe subjekti nuk ka qenë as në rolin e drejtueses së prokurorisë.

12. Ka firmosur me “ok” pastrimin e dosjes për tjetërsimin e 300 ha toka dhe plazh në bregun e **, çështje për të cilën janë arrestuar katër persona, mes të cilëve S. I., ish-kryetar i Komunës **.

Komisioni, me shkresën nr. *** prot., datë 8.10.2019, i ka kërkuar Prokurorisë së Rrethit Gjiqësor Durrës të dërgonte kopje të fashikujve përkatës për procedime penale ndaj shtetasit S. I., (ish-kryetar i Komunës **) dhe, nëse ka çështje të regjistruara në procedim e sipër, të informojë mbi statusin e çështjes.

Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës, me shkresën nr. *** prot., datë 18.10.2019, informon se në ngarkim të të pandehurit S. I., etj., Prokuroria e Rrethit Gjiqësor Durrës ka regjistruar procedimin penal nr. **, të vitit 2015, i cili është dërguar për gjykim në Gjykatën e Rrethit Gjiqësor Durrës, ndërsa një pjesë tjetër e këtij procedimi, dhe konkretisht ai me nr. **, i vitit 2018, është në hetim për veprën penale të parashikuar nga nenet 186, 248 dhe 287 të Kodit Penal. Prokuroria vendos bashkëngjitur në dispozicion 14 fashikujt e këtij procedimi penal.

Nga shqyrtimi i fashikujve (dosje shumë voluminoze) rezulton se roli i subjektit në këtë çështje ka qenë ai i drejtuesit të institucionit/person i deleguar që ka firmosur shkresat përcjellëse.

Në Prokurorinë e Rrethit Gjiqësor Durrës, mbi bazën e materialeve të ardhura nga Drejtoria e Policisë së Qarkut Durrës është regjistruar procedimi penal nr. **, datë 15.2.2016, për veprën penale “shpërdorim detyre”, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal, në ngarkim të shtetasit S.I. Ky shtetas ka kryer detyrën e kryetarit të ish-Komunës **, Durrës, nga 7.7.2011 – 31.7.2015.

Në Prokurorinë e Rrethit Gjiqësor Durrës është regjistruar procedimi penal nr. **, datë 8.7.2016, për veprën penale “shpërdorim detyre”, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal.

Duke qenë se të dy procedimet janë për të njëjtin fakt dhe janë në të njëjtën shkallë dhe gjendje hetimi, në datën 19.2.2016 janë bashkuar në një procedim të vetëm, duke e numërtuar me procedimin e numërtuar të parin nr. **, datë 8.7.2015.

Nga shqyrtimi i fashikullit rezulton se me vendimin për njoftimin e akuzës të datës 18.7.2018, shtetasi S. I., është marrë si i pandehur se ka kryer veprat penale “falsifikim i dokumenteve”, e kryer në bashkëpunim; “shpërdorim detyre”; dhe “korrupsion pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike”, e kryer në bashkëpunim.

Në datën 30.7.2018 prokurori ka vendosur ndarjen e procedimit penal nr. ***, datë 8.7.2015, në lidhje me faktet që kanë nevojë për hetime të mëtejshme, duke u numërtuar me nr. ***, datë 30.7.2018.

Nga shqyrtimi i fashikujve duket se veprimet hetimore janë ndjekur nga prokurori A. Sh.

Komisioni vlerëson se nuk qëndron pretendimi i ngritur në artikull, pasi sipas informacionit të administruar procedimi nr. ***, i vitit 2015, në ngarkim të të pandehurit S. I., etj., është dërguar për gjykim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës, ndërsa një pjesë tjetër e këtij procedimi, dhe konkretisht, ai me nr. ***, i vitit 2018, është në hetim për veprën penale të parashikuar nga nenet 186, 248 dhe 287 të Kodit Penal nga prokurori A. Sh.

13. Nuk filloi hetimin për dosjen e zyrtarëve të Inspektoratit Ndërtimor të Bashkisë Durrës, me lejimin e ndërtimeve pa leje në troje dhe hapësira publike.

Nga informacioni mediatik nuk kanë rezultuar të dhëna dhe, për pasojë, nuk është kërkuar dosja.

14. Ka bërë lojëra deri në pushim të çështjes dhe asgjësim të provave, së bashku me prokurorët E. K., dhe N. T., lidhur me kallëzimin penal nr. ***, për falsifikim dosjesh kundër gjyqtares Z. S., bërë nga shtetasja N. P.

Komisioni i është drejtuar me shkresë Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës, ku i ka kërkuar kopje të fashikullit për procedimin penal, filluar mbi kallëzimin nr. ***, të vitit 2019, nga shtetasja N. P.

Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës, me shkresën nr. *** prot., datë 8.11.2019, vendos në dispozicion kopje të fashikullit penal nr. ***, të vitit 2019, të regjistruar për veprën penale “ushtrim të ndikimit të paligjshëm ndaj personave që ushtrojnë funksione publike”, që parashikohet nga neni 245/1 i Kodit Penal.

Nga shqyrtimi i fashikujve rezulton se në Gjykatën e Apelit Tiranë është duke u gjykuar çështja civile me palë paditëse N. P., me të paditur I. A., dhe Zyra Përmbarimore “****”, me përmbarues S. H.

Në datën 16.5.2019 shtetasja N. P., ka dorëzuar në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda kallëzimin penal ndaj shtetasës Z. S., me detyrë gjyqtare pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, për veprën penale “shpërdorim detyre”, pasi kallëzuesja pretendon se në dosjen gjyqësore është gjendur një vendim gjyqësor i parapërgatitur, që sipas denoncueses favorizonte palën tjetër kundërshtare në proces. Gjithashtu, shtetasja N. P., paraqet kallëzim edhe kundër shtetasit I. A., i cili është kallëzuar për veprën penale “ushtrim të ndikimit të paligjshëm ndaj personave që ushtrojnë funksione publike”, parashikuar nga neni 245/1 i Kodit Penal, pasi kallëzuesja ka pretenduar se ky shtetas është parë në ambientet e hotel “****” me bashkëshortin e gjyqtares Z. S., në ditët kur kanë qenë duke u zhvilluar seancat gjyqësore.

Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda ia përcjell kallëzimin për kompetencë lëndore Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, e cila gjithashtu e përcjell këtë kallëzim në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës.

Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës ka regjistruar procedimin penal nr. ***, datë 14.6.2019, në ngarkim të shtetasit I. A., për veprën penale “ushtrim të ndikimit të paligjshëm ndaj personave që ushtrojnë funksione publike”, që parashikohet nga neni 245/1 i Kodit Penal. Për kallëzimin ndaj shtetasës Z. S., për veprën penale “shpërdorim detyre”, të parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal, Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës nuk ka regjistruar procedim penal dhe as ka dalë me vendim për mosfillimin e procedimit penal.

Në datën 11.9.2019 Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës ka dërguar në Gjykatën e Shkallës së Parë Durrës kërkesën për pushimin e procedimit penal nr. ***, të vitit 2019.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës, me vendimin nr. ***, datë 24.10.2019, ka vendosur mospranimin e kërkesës për pushimin e procedimit penal nr. ***/2019, dhe kthimin e akteve të këtij procedimi për vazhdimin e hetimeve. Në vendimin e saj, gjykata ka vlerësuar se hetimet nuk janë të plota dhe dosja i është kthyer prokurorit për plotësimin e hetimeve, duke caktuar edhe veprimet hetimore shtesë ku, ndër të tjera: përderisa ka një kallëzim penal edhe ndaj shtetas Z. S., prokurori duhet të kishte dalë me vendim apo kërkesë edhe për këtë rast, për këtë shkak urdhërohet prokurori që të përpilojë një akt procedural edhe për këtë rast.

Dosja shkoi në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Durrës pikërisht për shkak se e kallëzuara ushtronte detyrën e gjyqtares në Gjykatën e Apelit.

Në datën 30.10.2019 është dërguar ankimi nr. ***, datë 24.10.2019, i prokurorit N. T., kundër Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës.

Vëzhguesi ndërkombëtar ka paraqitur një opinion me nr. *** prot., datë 14.11.2019, sipas të cilit në vijim të informacionit të marrë nga Komisioni, konstatohet se në datën 16.5.2019 shtetasja N. P., ka depozituar në Gjykatën për Krime të Rënda Tiranë një kallëzim penal në ngarkim të gjyqtares Z. S., dhe në ngarkim të shtetasit I. A. Kallëzimi penal i është dërguar Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Durrës, e cila ka regjistruar kallëzimin penal nr. ***, viti 2019, për veprën “shpërdorim detyre”, vetëm në ngarkim të shtetasit I. A. Pas analizës së zhvillimeve të kësaj çështjeje penale, nuk rezulton të ketë filluar ndonjë hetim, ose të jetë regjistruar ndonjë procedim penal në ngarkim të shtetas Z. S.

Mungesa e kontrollit që duhej të ishte ushtruar nga subjekti i rivlerësimit, znj. A. J., mbi kryerjen e duhur të veprimeve përkatëse të procedimit, në lidhje me dyshimet për korrupsion në ngarkim të një anëtareje të gjyqësorit, është tepër shqetësuese – specifikisht, mungesa e mbikëqyrjes mbi mosregjistrimin e emrit të shtetas Z. S., dhe mosfillimi i hetimit (ose edhe mundësia për vlerësimin nëse duhej të ishin filluar hetimet).

Lidhur me këtë rezultat, subjektit i kaloi barra e provës, bazuar në nenin 52, të ligjit nr. 84/2016, për të dhënë argumente dhe prova bindëse për të justifikuar mungesën e kontrollit për mosregjistrimin/hetimin pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Durrës, të emrit të gjyqtares Z. S., si rezultat i kallëzimit të depozituar pranë Prokurorisë për Krime të Rënda dhe, më pas, të transferuar pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Durrës.

Lidhur me opinionin e vëzhguesit ndërkombëtar, subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar: “... ju bëj me dije se aktet e këtij kallëzimi penal, të ardhura nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës, janë cikluar nga zv/drejtuesi i prokurorisë, A. F., (kështu veprohet në mungesën e drejtuesit) dhe cikluar më tej pas shortit të prokurorit i çështjes. Rregulli që zbatohet në këtë rast është se drejtuesi ose zv/drejtuesi, në mungesë të drejtuesit, orienton duke caktuar dispozitat për të cilat zyra e regjistrimit do të hedhë shortin dhe, më pas, është prokurori i çështjes i cili vendos lidhur me regjistrimin/ose mosfillimin e materialit për veprën penale që ai çmon se duhet të regjistrojë materialin. Veprat penale të vendosura për zyrën e regjistrimit/prokurorin, janë orientuese dhe nuk janë detyruese për prokurorin, pasi prokurori është tërësisht i pavarur në ushtrimin e detyrës. Kushtetuta, neni 25, i Kodit të Procedurës Penale dhe ligji organik parashikon se prokurori është i pavarur në ushtrimin e funksioneve të tij. Nënvizoj faktin se ndryshimet e fundit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ligjit nr. 35/2017, ‘Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7905, datë 21.3.1995, ‘Kodi i Procedurës Penale të Republikës së Shqipërisë’ dhe ligjit nr. 97/2016, ‘Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë së Republikës së Shqipërisë’, ndryshuan në thelb funksionimin e prokurorisë nga një organ i

centralizuar¹⁴ në një organ të pavarur që garanton mbarëvajtjen, kontrollin e veprimeve të saj dhe respekton pavarësinë e brendshme të prokurorëve gjatë hetimit dhe përfaqësimit të akuzës në gjykim. Hetimi dhe ndjekja penale, është kompetencë vetëm e prokurorëve të çështjeve që ushtrojnë në pavarësi të brendshme kompetencat e tyre në prokuroritë pranë gjykatës së shkallëve përkatëse, duke u parashikuar që ligjshmëria e veprimeve të prokurorit të çështjes, kryer gjatë hetimeve paraprake dhe gjykimit të çështjes, janë objekt shqyrtimi dhe vlerësimi vetëm nga gjykata.

Drejtuesi i prokurorisë në zbatim të ligjit organik, mund të japë udhëzime jo të detyrueshme për një çështje konkrete¹⁵, të cilat nuk duhet të cenojnë pavarësinë e prokurorit për zgjidhjen e çështjes. Kjo e fundit është detyrim dhe përgjegjësi personale e prokurorit të çështjes.”

Lidhur me shqetësimin e paraqitur nga vëzhguesi ndërkombëtar për mungesën e kontrollit që duhej të ishte ushtruar nga subjekti, mbi kryerjen e duhur të veprimeve përkatëse të procedimit në lidhje me dyshimet për korrupsion në ngarkim të një anëtareje të gjyqësorit, subjekti sqaron se materiali kallëzues fillimisht është trajtuar nga Prokuroria për Krime të Rënda, e cila është kompetente për hetimin e veprave të korrupsionit të gjyqtarëve ose prokurorëve. Pra, kalimi i këtij materiali për kompetencë në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe më pas në atë të Durrësit, nuk përfshin hetimin e dyshimeve për korrupsion ndaj gjyqtarës.

Specifikisht, vëzhguesi ndërkombëtar shpreh shqetësim për mungesën e mbikëqyrjes mbi mosregjistrimin e emrit të shtetasës Z. S., dhe mosfillimi i hetimit (ose dhe mundësia për vlerësimin nëse duhej të ishin filluar hetimet). Lidhur me këtë konstatim subjekti sqaron se janë ushtruar kompetencat ligjore për hedhjen në short të materialit kallëzues në mënyrë transparente. Gjithashtu, saktëson se nga zv/drejtuesi në këtë rast janë caktuar si dispozita për t'u hedhur në short materiali nenet 248 dhe 245/1 të Kodit Penal. Ky fakt rezultoi nga shënimet e kryera në regjistër dhe hedhja në short e materialit hetimor.

Me ndryshimet e ligjit nr. 35/2017, garanti ligjor për kontrollin e punës së prokurorit është gjykata, e cila merr vendim si për kërkesat për pushimin e procedimeve, ashtu dhe për kërkesat për dërgimin e çështjes për gjykim. Veprimet hetimore dhe mënyra e zgjidhjes së çështjes vlerësohen nga gjyqtari i hetimit paraprak dhe referuar neneve 329/b dhe 329 të Kodit të Procedurës Penale ku, ndër të tjera, parashikohet se gjykata mund të vendosë “... kthimin e akteve prokurorit dhe vazhdimin e hetimeve, kur çmon se ato janë të paplota, duke përcaktuar drejtimit e thellimit të tyre dhe, kur është rasti, edhe veprimet që duhet të kryhen, si dhe cakton afatin brenda të cilit hetimet duhet të përfundojnë”. Në rastin konkret gjykata ka kthyer çështjen për plotësim, duke urdhëruar kryerjen e disa veprimeve të tjera hetimore, ndërsa nga prokurori është ushtruar ankimi në Gjykatën e Apelit Durrës.

Duke iu rikthyer procedimit penal nr. ***/2019, gjykata ka kthyer çështjen për plotësim, duke urdhëruar kryerjen e disa veprimeve të tjera hetimore, ndërsa nga prokurori është ushtruar ankimi në Gjykatën e Apelit Durrës. Si i tillë, ky vendim ende nuk ka marrë formë të prerë. Prandaj, vendimi i gjykatës së shkallës së parë për këtë procedim nuk mund të konsiderohet se konstaton në mënyrë përfundimtare të metat e hetimit të prokurorit në këtë çështje.

Bashkëlidhur subjekti vë në dispozicion: kopje të vendimit të gjykatës; shënimin e zv/drejtuesit për hedhjen në short; kopje të shënimeve të bëra në fashikull për hedhjen në short, fleta nr. *** e fashikullit të procedimit penal; shënimi për nenet 248 dhe 245 është shënimi i zv/drejtuesit, i cili është orientuesë fotokopje e regjistrimit; akt konstatimi; vendim gjykate.

➤ **Informacioni i marrë nga “Boldnews. al¹⁶”**

¹⁴ Neni 148/2 i Kushtetutës para ndryshimeve me ligjin nr. 76/2016.

¹⁵ Neni 48/2 i ligjit nr. 97/2016, “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, që parashikon se: “2. Udhëzimet për çështje konkrete nuk janë të detyrueshme”.

¹⁶ <https://boldnews.al/2019/10/04/vetingu-Anita-Jella-dyshime-per-shpenzimet-dhe-deshtimet-me-peshqit-e-medhenj-te-Durresit/>

15. Burime nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Durrës, në komunikim me “*Boldnews.al*”, kanë ngritur dyshime se zyrtarë të Kadastrës dhe ALUIZNI-t Durrës, të arrestuar së fundmi për shpërdorim detyre dhe falsifikim dokumentesh, kanë fituar shumë shpejt lirinë pas ndërhyrjeve të drejtueses Anita Jella.

Në gusht të vitit 2019 prokurori A. N., nisi një hetim mbi drejtuesit e lartë të ALUIZNI-t dhe Kadastrës në qytetin bregdetar. Në vijim të veprimeve procedurale, prokurori ka urdhëruar fillimisht ndalimin e zv/drejtorit të Kadastrës së Durrësit, A. I., njëkohësisht Sekretar i Përgjithshëm i Partisë Socialiste në degën Durrës. Më tej, prokurori urdhëroi ndalimin e zv/drejtueses tjetër të Kadastrës, L. K., si dhe u shpall në kërkim ish-drejtori i ALUIZNI-t, F. Gj. Por, asnjë prej këtyre zyrtarëve nuk është pas hekurave, pasi, me firmë të drejtueses Anita Jella, akuza në gjykatë u përfaqësua nga të tjerë prokurorë, të cilët kërkuan lirimin e tyre.

Në 10 gusht të vitit 2019, prokurori A. N. kërkoi ndalimin e shtetasit A. I., një prej zyrtarëve më të rëndësishëm në Durrës, i dyshuar për shpërdorim detyre dhe falsifikim dokumentesh, lidhur me një pronë në bregun e ***.

Policia nuk arriti ta ndalojë shtetasin A. I. Ai u dorëzua pas 5 ditësh, në një veprim që burimet nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Durrës e konsiderojnë si një “bashkëpunim” të tij me drejtueset e institucionit, Anita Jella dhe A. F., për zbutjen e pozitës së tij procedurale.

Shtetasi A. I., dorëzohet në 15 gusht, në një moment kur prokurori që kishte urdhëruar ndalimin kishte marrë lejen vjetore.

Në seancën për masë sigurie, drejtuesi i Prokurorisë së Durrësit caktoi prokurorin S. N., për të përfaqësuar akuzën ndaj shtetasit A. I. Në përfundim të seancës, zyrtari i lartë fitoi lirinë, duke qëndruar më pak se 10 orë në qeli.

Në 18 shtator, në vijim të të njëjtit hetim, prokurori A. N., urdhëron ndalimin e zv/drejtueses së Kadastrës, L. K., si dhe shpallet në kërkim ish-drejtuesi i ALUIZNI-t, F. Gj.

Në seancën për masën e sigurisë për shtetasin L. K., Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Durrës përfaqësohet me një tjetër prokuror, të caktuar nga drejtuesja Anita Jella. Prokurori i ri kërkon në seancë masën e butë “detyrim paraqitjeje”. Gjykata pranoi këtë kërkesë, duke i rikthyer shumë shpejt lirinë zyrtares L. K.

Së fundmi, prokurori A. N., kërkoi arrestimin e drejtuesit të Kadastrës, L. P. Por, ndryshe nga dy rastet e mëparshme, kësaj radhe prokurori i çështjes iu drejtua vetë gjykatës për caktimin e masës së sigurisë “arrest me burg”, në mungesë.

Burimet nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Durrës informuan “*Boldnews.al*” se kërkesa e prokurorit të çështjes drejtuar gjykatës, u mbaj për rreth 5 ditë nga drejtuesja Anita Jella, pa kryer veprimin administrativ të nënshkrimit të shkresës përcjellëse.

Vetëm pasi prokurori i çështjes, në një komunikim zyrtar me drejtuesen, i kujtoi se bllokimi i dërgimit të kërkesës në gjykatë përbën shkak për nisjen e hetimit për “shpërdorim detyre” ndaj Anita Jellës, kjo e fundit e dërgoi rastin në gjykatë.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës pranoi kërkesën për “arrest me burg” për shtetasin L. P., i cili u prangos në zyrën e tij. Ky shtetas është i vetmi ndër zyrtarët e lartë të përfshirë në këtë hetim që qëndron pas hekurave.

Subjekti shpjegon¹⁷ se procedimi penal në ngarkim të shtetasit F. Gj., për legalizime gjatë kohës kur ky shtetas ka qenë drejtues i zyrës së ALUIZNI-t Durrës, nuk është i mbyllur, por vazhdojnë hetimet, të cilat ndiqen nga prokurori A. Sh.

Subjekti bashkëlidh vërtetimin nr. *** prot., datë 4.10.2019, sipas të cilit Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës ka regjistruar procedimin penal nr. ***, datë 5.7.2018, për

¹⁷ Me e-mail-in datë 4.10.2019.

veprën penale të parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal etj., në lidhje me legalizimin e objektit të subjektit K. Në lidhje me këtë çështje hetimi vazhdon.

Komisioni, me shkresën nr. *** prot., datë 8.10.2019, i ka kërkuar Prokurorisë së Rrethit Gjirokastrë Durrës kopjen e fashikujve që i përkasin procedimeve penale në ngarkim të shtetasve F. Gj., dhe A. I., për legalizime kur këta shtetas kanë qenë drejtues në Zyrën e ALUIZNI-t Durrës.

Me shkresën nr. *** prot., datë 18.10.2019, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës informon se për sa i përket procedimeve penale në ngarkim të shtetasit F. Gj. etj., rezulton se në datën 15.2.2018 është regjistruar procedimi penal nr. ***, të vitit 2018, për veprën penale të parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal, në ngarkim të këtij shtetasi në lidhje me dyshimet për legalizim të objekteve pa leje, në kundërshtim me ligjin, në kohën kur drejtonte zyrën e ALUIZNI-t Durrës. Ky procedim është bashkuar edhe me disa procedime të tjera dhe aktualisht është në hetim dhe hetohet nga prokurorja E. P.

Subjekti, mbi arrestimin e shtetasit L. P., sqaron se¹⁸ kërkesa drejtuar gjykatës për caktimin e masës së sigurimit ndaj këtij shtetasi është dërguar në zyrën e saj në orën 15:30, datë 26.9.2019, ditën e enjte nga prokurori A. N. Nisur nga rëndësia e faktit të shprehur në kërkesë, subjektit i është kërkuar t'i vihen në dispozicion të gjitha materialet hetimore lidhur me këtë rast, pasi nuk ishte vënë në dijeni të tyre nga prokurori i çështjes, si dhe për faktin se ky prokuror nuk bën pjesë në Seksionin e Krimit Ekonomik. Gjithashtu, nisur nga orari dhe nga angazhimi i subjektit në procesin e rivlerësimit, ku në atë datë dhe orar ka nisur në Komision parashtrimet përfundimtare dhe materialet e skanuara, shqyrtimi i dokumentacionit të kërkesës është lënë për ditën e nesërme.

Të nesërmen në datën 27.9.2019, ditën e premte, subjekti, për arsye objektive dhe të angazhimeve në këtë proces, nuk ka qenë në punë dhe ka autorizuar që materiali t'i kalohet për studim dhe për t'u firmosur drejtuesit të Seksionit të Krimit Ekonomik.

Pas studimit të materialit nga ky i fundit, subjekti është bërë me dije se Prokuroria e Rrethit Gjirokastrë Durrës dhe seksioni që ai drejtonte kishte në hetim edhe dy procedime të tjera lidhur me këto fakte dhe persona, për të cilët po kryheshin veprime proaktive si, përgjime telefonike etj., dhe se veprimet e kryera në një dosje hetimore mund të prishnin veprimet apo provat e procedimeve të tjera, dhe në këtë kuadër duhej bashkëpunim midis të gjithë prokurorëve që ndiqnin çështjet për të rakorduar procedimet penale. Në këtë kuadër, duke mos pasur asnjë problem lidhur me afatet për dorëzimin e kësaj kërkesë në gjykatë, në kuptim të Kodit të Procedurës Penale është vendosur që ditën e hënë, pasi atë ditë ishte e premte, të mblidheshim në një mbledhje me të gjithë drejtuesit e prokurorisë dhe prokurorët që ndiqnin çështjet, për të organizuar punën dhe të bashkërendoheshin veprimet konkrete lidhur me shtetasit nën hetim. Prokurori i çështjes nuk është paraqitur për të diskutuar dhe subjekti, si drejtuese, ka përpiluar një udhëzim me karakter jo detyrues. Duke parë që prokurori i çështjes nuk e ka marrë parasysht këtë udhëzim, subjekti ka firmosur shkresën përcjellëse drejtuar gjykatës për caktimin e masës së sigurimit. Për sa i përket shënimit shantazhues dhe jo etik të tij në këtë udhëzim, po kryhen procedurat ligjore për ta referuar rastin si shkelje etike.

Subjekti vendos në dispozicion të Komisionit:

- a. shkresën nr. *** prot., (A.N), datë 26.9.2019, drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjirokastrë Durrës për dërgim kërkesë për masë sigurie;
- b. udhëzimin me karakter jo të detyrueshëm në çështjen penale nr. ***, të vitit 2019;
- c. grafikun e gatishmërisë për muajin gusht.

Në datën 31.10.2019 vëzhguesi ndërkombëtar ka bërë një vizitë pranë Prokurorisë së Rrethit Gjirokastrë Durrës, me qëllim verifikimin e përmbajtjes së një numri denoncimesh (të publikuar

¹⁸ Me e-mail-in datë 4.10.2019.

në artikuj gazetash dhe të marra në formë anonime nga Operacioni Ndërkombëtar i Monitorimit (në vijim ONM) në lidhje me dyshimet e shkeljeve të kryera nga subjekti i rivlerësimit, znj. Anita Jella, e cila dyshohej se në cilësinë e drejtueses së kësaj prokurorie kishte kryer veprime për vonesën e arrestimit të një prej të dyshuarve, L. Z. P., në shtator të vitit 2019.

Vëzhguesi ndërkombëtar ka paraqitur gjetjen si vijon:

Janë konstatuar:

- 1) Të enjten, datë 26.9.2019, prokurori i çështjes A. N., ka përgatitur një kërkesë (në emrin e tij) drejtuar gjykatës, për të urdhëruar arrestimin e të dyshuarit L. P.; kërkesa mban datën 26.9.2019.
- 2) Të enjten, datë 26.9.2019, prokurori i çështjes ka përgatitur një shkresë shoqëruese drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, për kërkesën e tij (në emrin e znj. Anita Jella, që do të nënshkruhej prej saj, që mban datën 26.9.2019).
- 3) Të enjten, datë 26.9.2016, shkresa shoqëruese (nr. *** prot., (A.N), datë 26 shtator, është nënshkruar nga znj. Anita Jella. Dosja nr. *** përmban një kopje të kësaj shkrese shoqëruese, ndërsa sekretaria e gjykatës ka një kopje të po kësaj shkrese me shkrim dore, e cila, sipas sekretarisë, është siguruar nga gjykata që tregon se shkresa është marrë nga gjykata të hënën më 30.9.2019.
- 4) Të hënën, datë 30.9.2019, znj. Anita Jella ka nxjerrë një “udhëzim” (të natyrës jo urdhëruese në lidhje me çështjen penale nr. ***, të vitit 2019) drejtuar prokurorit të çështjes, ku ka kërkuar:
 - a) regjistrimin e emrit të të dyshuarit (L. Z. P.) në regjistrin përkatës hetimor, si i dyshuar i çështjes;
 - b) kryerjen e veprimeve hetimore shtesë në mënyrën e marrjes së të gjitha akteve dhe provave për të përmbushur kriterin e “dyshimeve të arsyeshme”, me qëllim caktimin e masës së sigurimit personal;
 - c) bashkërendimin e punës me prokurorë të tjerë, të cilët po kryejnë hetime kundër punonjësve të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, për qëllimin e marrjes së provave të tjera për të shmangur pengimin e hetimeve të këtyre çështjeve të tjera në hetim, ose bashkimin e tyre në një procedim penal.
- 5) Të hënën, datë 30.9.2019, prokurori i çështjes ka nxjerrë një urdhër për protokollin e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Durrës, për regjistrimin e emrit të shtetasit L. P., si i dyshuar i çështjes.
- 6) Të hënën, datë 30.9.2019, kërkesa për urdhërimin e arrestimit (datë 26.9.2019), e nënshkruar nga prokurori i çështjes dhe shkresa shoqëruese (datë 26.9.2019), e nënshkruar nga drejtuesja e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Durrës i është dërguar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës.
- 7) Të martën, datë 1.10.2019, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës ka vendosur të pranojë kërkesën e prokurorit të çështjes dhe të caktojë masën “arrest me burg”, në bazë të nenit 238, të Kodit të Procedurës Penale (vendimi nr. ***, datë 1.10.2019, i gjykatës), në bazë të kërkesës së prokurorit.

Ka dyshime në media dhe në një denoncim të depozituar nga ONM-ja, sipas të cilit subjekti i rivlerësimit, z. Anita Jella, do të kishte shkaktuar një vonesë prej katër ditësh (nga e enjtja, datë 26 deri të hënën datë 30.9.2019) në depozitimin e kërkesës për arrestimin e shtetasit L. Z. P., nga prokurori i çështjes A. N.

Edhe pse një version i ngjarjeve mund të lidhet me nevojën, vendosur nga znj. Anita Jella pas konsultimit me z. E. K., për të mbajtur një mbledhje të prokurorëve që hetojnë çështje të

ngjashme të hënën pasardhëse, 30.9.2019, nuk ka gjurmë për ekzistencën e kësaj mbledhjeje në ndonjë prej dokumenteve të shqyrtuara nga vëzhguesi ndërkombëtar dhe, për këtë arsye, vëzhguesi ndërkombëtar paraqet një

GJETJE¹⁹

që ka ndodhur një vonesë, e cila i atribuohet znj. Anita Jella, në ndjekjen e procedurës si drejtuese e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Durrës, në procedimin nr. ***²⁰ sepse:

- 1) nuk provohet që, më 26.9.2019, kjo mbledhje ishte arsyeja për shtyrjen e depozitimit të kërkesës për arrestim të përgatitur nga prokurori i çështjes A. N., ose që mbledhja të jetë mbajtur;
- 2) përveç kësaj, fakti që vendimi nr. ***, datë 1.10.2019, i gjykatës ka caktuar masën “arrest me burg” në bazë të kërkesës së prokurorit, pra, pa hetimin shtesë të kërkuar nga subjekti i rivlerësimit, znj. Anita Jella, me udhëzimin e saj “jo urdhërues”, është provë që provon se kërkesa e subjektit për prokurorin e çështjes ishte e panevojshme në këtë pikë; ky konkluzion konfirmohet më tej nga vendimi nr. ***, datë 4.10.2019, i gjykatës, referuar edhe në shtojcat e kësaj gjetjeje;
- 3) e fundit, por jo nga rëndësia, është evidente që ishte e mundshme që të kërkohej regjistrimi i emrit të shtetasit L. P., në regjistrin përkatës të prokurorisë që në datën 26 (të enjten) ose 27 (të premtën) shtator 2019, pa pritur për të hënën, 30.9.2019.

Në vijim, Komisioni i ka kërkuar shpjegime subjektit të rivlerësimit, e cila, ndër të tjera, shpjegon se arsyet e takimit, lënë për t’u zhvilluar në datën 30.9.2019, ishin për t’u informuar dhe rakorduar punën në prokurori, me qëllim mosdëmtimin e procedimit penal, i cili ndiqej me veprime proaktive nga prokurori A. Sh., në lidhje me Kadastrën e Durrësit. Prokurori A. N., i cili kishte njoftim për takimin, nuk është paraqitur dhe nuk ka dhënë arsye për këtë mosparaqitje. Pas marrjes së informacionit me shkrim, nga prokurori A. Sh., dhe S. B., dhe diskutimit me z. E. K., (drejtues i Seksionit të Hetimit të Krimit Ekonomiko-Financiar dhe Kibernetik), nga subjekti është vijuar me përpilimin e një udhëzimi me karakter jodetyrues, i cili i është komunikuar prokurorit të çështjes. Udhëzimi nuk është marrë në konsideratë prej tij dhe subjekti ka nënshkruar menjëherë shkresën përcjellëse, duke dërguar materialin në gjykatë. Për sa më lart, subjekti sqaron se nuk u arrit që takimi të bëhej.

Komisioni i është drejtuar me shkresë Gjykatës së Apelit Durrës, duke i kërkuar vendimin e Gjykatës së Apelit mbi ankimin e vendimeve nr. *** dhe nr. *** të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës.

Gjykata e Apelit, me shkresën nr. *** prot., datë 11.11.2019, vendos në dispozicion të Komisionit vendimin penal nr. ***, datë 18.10.2019, të Gjykatës së Apelit Durrës, me palë kërkuese: Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Durrës, me objekt “caktimin e masës së sigurimit ndaj shtetasit L. P., dyshuar se ka kryer veprën penale ‘shpërdorim detyre’, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal”.

Gjykata e Apelit Durrës, me këtë vendim, ndër të tjera, ka vendosur ndryshimin e vendimit nr. ***, datë 1.10.2019, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, që ka caktuar masën e sigurimit “arrest në burg” ndaj shtetasit L. P., dhe vendimit nr. ***, datë 4.10.2019, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, që ka vendosur vazhdimin e zbatimit të kësaj mase sigurimi, si dhe caktimin e masës së sigurimit “detyrim për t’u paraqitur para policisë gjyqësore” ndaj personit nën hetim L. P.

Mendimi i pakicës për vendimin e mësipërm, i cili shprehet se Gjykata e Apelit Durrës duhet të vendoste “ndryshimin e vendimit nr. ***, datë 1.10.2019, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor

¹⁹ Për më tepër, shihni gjetjen me nr. *** prot., datë 6.11.2019, të paraqitura nga Operacioni Ndërkombëtar i Monitorimit.

²⁰ Duhet theksuar se shkresa shoqëruese e kërkesës për urdhërimin e arrestimit është dërguar në datën 26.9.2019, datë përpara momentit kur është nxjerrë udhëzimi jo urdhërues.

Durrës, që ka caktuar masën e sigurimit ‘arrest në burg’ ndaj shtetasit L. P., dhe ndaj vendimit nr. ***, datë 4.10.2019, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, e cila ka vendosur vazhdimin e zbatimit të kësaj mase sigurimi, duke mos u caktuar asnjë masë sigurimi ndaj personit në hetim L. P.

Të gjitha informacionet në portalin “*Bold News*” për pasurinë e subjektit janë hetuar nga Komisioni.

Në vijim, Komisioni ka hetuar lidhur me: denoncimin anonim të datës 3.10.2019; denoncimin anonim nr. *** prot., datë 14.10.2019; denoncimin nr. *** prot., datë 11.10.2019, si dhe informacionet e marra nga mediat nga portali “Pamfleti.net²¹”, datë 16.10.2019.

59. Pas vlerësimit të fakteve dhe dokumentacionit mbi denoncimet nuk u vërejtën rrethana për fakte që krijojnë bindjen se ka pasur shkelje ligjore, apo të dhëna e *indicie* për subjektin e rivlerësimit, për të vijuar me hetime të mëtejshme.

Konkluzione për vlerësimin e aftësive profesionale

60. Vlerësimi i aftësisë profesionale të subjektit të rivlerësimit, znj. Anita Jella, u bazua në: (i) gjetjet e mësipërme; dhe (ii) pas një analize të bërë në përputhje me ligjin nr. 84/2016, “Për vlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ligjin nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, kreun II, si dhe ligjin nr. 97/2016, “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”.

61. Në vlerësim të informacioneve të mbledhura gjatë hetimit administrativ lidhur me denoncimet, trupi gjykues vlerëson se në asnjë rast nuk i referohen shkeljeve konkrete të bëra nga subjekti i rivlerësimit në dosjet penale të hetuara prej saj. Denoncimet trajtonin çështje që kishin të bënin me pozicionin e saj si drejtuese, të cila në vlerësim me kompetencat e përcaktuara në ligjin nr. 97/2016, tregonin sjellje korrekte të subjektit të rivlerësimit në shumicën e rasteve të hetuara. Në funksion të pozicionit dhe rolit kushtetues të prokurorisë me ndryshimet e bëra në legjislacion, tashmë garantohet pavarësia e këtij organi në raporte me organet e tjera jashtë tij, si dhe pavarësia e brendshme e prokurorëve në hetimin dhe ndjekjen penale. Këto ndryshime sollën në vitin 2016 kalimin e prokurorisë nga një organ i centralizuar në një decentralizim të pjesshëm funksional të saj. Kjo garanci kushtetuese²², krahas pavarësisë, synon të garantojë ushtrimin e këtij funksioni në mënyrë të përgjegjshme dhe efektive. Sipas kuptimit të pavarësisë prokuroria është organ me pavarësi të plotë në ushtrimin e funksioneve, gjë që do të thotë se fillimi i procedimit penal, vënia para përgjegjësisë penale, pushimi, pezullimi i çështjeve, ose dërgimi në gjyq janë attribute të prokurorisë. Dispozita parashikon një decentralizim funksional lidhur me pavarësinë e brendshme, ku ushtrimi i attributeve dhe funksioneve të përcaktuara me ligj duhet të vlerësohet dhe kontrollohet nga gjykata sipas ligjit²³. Organizimi i brendshëm i prokurorisë dhe pavarësia e prokurorëve për hetimin dhe ndjekjen penale garantohet nga Kushtetuta dhe ligji. Në kuptim të ligjit nr.96/2016, tani është gjykata që do të kryejë kontrollin funksional të prokurorëve, që më parë kryhej nga prokurorët më të lartë/drejtuesit.

61.1 Në vlerësim të rezultateve të hetimit në raport me kompetencat ligjore të drejtuesve, trupi gjykues arriti në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka zbatuar ligjin brenda kompetencave të saj si drejtuese dhe se mosveprimet e saj të konstatuara në dy raste nuk mund të përbëjnë shkak për vlerësimin profesional të saj me mangësi apo të papërshtatshëm, referuar nenit 44, të ligjit nr. 84/2016. Në përfundim, relatori i çështjes propozoi për subjektin e rivlerësimit, znj. Anita Jella, “e aftë”.

²¹ <https://pamfleti.net/ironia-e-drejtësisë-se-re-prokuroria-e-zgje-Anita-Jella-kulcedra-e-plazhit-te-Durresit-kerkon-nje-vend-ne-spak/>

²² Neni 148 i Kushtetutës, ndryshuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016.

²³ Neni 148/2 i Kushtetutës përpara ndryshimeve të ligjit nr. 76/2016: “Prokurorët janë të organizuar dhe funksionojnë pranë sistemit gjyqësor si një organ i centralizuar”.

62. Në përfundim, trupi gjykues arriti në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit ka treguar cilësi të pranueshme në punë, gjykim të drejtë, është eficient dhe efektiv në masë të pranueshme. Ajo ka arritur nivelin minimal kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale, sipas parashikimit të germës “c”, të nenit 59/1, të ligjit nr. 84/2016.

63. Trupi gjykues ka vlerësuar se, pavarësisht se subjekti i rivlerësimit ka plotësuar kërkesat e pikës 1, të nenit 59, të ligjit nr. 84/2016, vlerëson të transferojë pranë organit kompetent për inspektim procedimit penal nr. ***, të regjistruar në datën 10.3.2014 dhe transferimin e dy çështjeve që lidhen me ndjekjen e procedurës si drejtuese e Prokurorisë Durrës, në procedimin penal nr. ***/19, dhe kallëzimin penal nr. ***/2019, pranë organit kompetent për t’u marrë parasysh për vlerësimin periodik të subjektit të rivlerësimit.

QËNDRIMI DHE MENDIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT

64. Gjatë të gjitha fazave të hetimit, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave, si dhe krijimin e bindjes së brendshme, trupi gjykues ka komunikuar me anë të postës elektronike me subjektin e rivlerësimit.

65. Subjekti është treguar bashkëpunues gjatë gjithë periudhës së hetimit kryesisht, duke iu përgjigjur pyetësorit të dërguar dhe duke dhënë në mënyrë shteruese informacionin e kërkuar. Ajo ka qenë e gatshme për të bashkëpunuar me Komisionin në vlerësimin e fakteve dhe rrethanave të dala gjatë hetimit, si dhe krijimin e bindjes së brendshme për anëtarët e trupit gjykues.

66. Trupi gjykues konstaton se subjekti i rivlerësimit ka qenë bashkëpunues gjatë të gjithë procesit, në përputhje me nenin 48, të ligjit nr. 84/2016. Ajo ka zbatuar me përpikëri afatet e përcaktuara nga Komisioni, si dhe ka dhënë shpjegimet dhe provat e nevojshme.

PËR KËTO ARSYE,

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në pikën 5, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016, pasi u mblodh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Theo Jacobs dhe, në bazë të nenit 58, pika 1, germa “a”, si dhe të nenit 59, pika 1, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, pasi konstatoi se subjekti ka arritur një nivel të besueshëm të vlerësimit të pasurisë, një nivel të besueshëm të kontrollit të figurës, si dhe një nivel kualifikues të vlerësimit të aftësive profesionale,

V E N D O S I:

1. Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, znj. Anita Jella, prokurore dhe drejtuese në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Durrës.
2. Transferimin e procedimit penal nr. ***, të regjistruar në datën 10.3.2014, pranë organit kompetent për inspektim dhe vlerësim.
3. Transferimin e dy çështjeve që lidhen me ndjekjen e procedurës si drejtuese e Prokurorisë të Rrethit Gjyqësor Durrës, pranë organit kompetent, për t’u marrë parasysh për vlerësimin periodik të subjektit të rivlerësimit.
4. Vendimi, i arsyetuar me shkrim, u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit, në përputhje me pikën 7, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016.

5. Pika 1 e këtij vendimi mund të ankimohet pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelit nga Komisioneri Publik dhe/ose subjekti i rivlerësimit 15 ditë nga data e njoftimit të Komisionit. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.

U shpall sot në datën 10.12.2019.

ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES

KRYESUESE

Xhensila Pine

ANËTARE

Etleđa Çiftja

RELATORE

Valbona Sanxhaktari

Sekretare gjyqësore

Fiorela Mandro